



Shkruan: Pandeli MAJKO

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

HAXHIU ZGJEDHET KRYEPARLAMENTARE, POR VETËVENDOSJE BLLOKON KONSTITUIMIN E PLOTË TË KUVENDIT

FAQE 4-5



Deputetët e Kuvendit të Kosovës rizgjedhën të mërkurën Albulena Haxhiun në postin e kryetares së Kuvendit, por nënkryetarët nuk u hodhën në votim. Ligjvënësit shfaqën mospajtime lidhur me mënyrën e votimit të

nënkryetarëve. Pengesë u bë edhe formulimi i përdorur nga Lista Serbe, e cila propozoi Sllavko Simiqin për postin e nënkryetarit. Formulimi "në emër të popullit serb" u konsiderua jokushtetues nga

kryetarja Haxhiu, e cila e shtyu seancën për të premtën. Ndërkohë, partitë parlamentare PDK dhe LDK kanë drejtuar akuza ndaj LV-së, duke e bërë përgjegjëse për bllokimin e konstituimit të plotë të Kuvendit

**A MUND HAXHIU
TA USHTROJË
DETYRËN E
PRESIDENTIT
EDHE PËR
GJASHTË MUAJ
TË TJERË?**

F. 3



**MYFTIU TËRNAVA
DHE IPESHKVI
DODË GJERGJI
NË MBËSHETJE
TË MARSHIT
PËR LIRI MË
12 SHTATOR**

F. 5



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +389 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVË
STYROLKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 870
044 500 878 | 049 500 870

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



**25 VJET PAS 11 SHTATORIT,
A MUND TË KTHEHET AFGANISTANI
NË STREHË TË TERRORIZMIT
GLOBAL?**

F. 2

**PAL LEKAJ DËNOHET ME TRI VJET E
TETË MUJ BURGIM NË RIGJYKIM
PËR RASTIN E 53 MILIONËSHIT**

F. 7

**INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI
MBËSHETËTË "MARSHIN PËR LIRI"**

F. 6

EKONOMI



**OYMYRI SJELL MILIONA:
KU DUHET TË INVESTOHEN?**

F. 8

**AKB-JA NË PARLAMENTIN
EVROPIAN: SEKTORI PRIVAT I
KOSOVËS DUHET TË PËRFITOJË
MË SHUMË NGA PLANI I RITJES**

F. 3

SPORT

Përkushtimi shpërblehet,
suksesi mbështetet.
625,325
Për sportistët dhe trajnerët e Kosovës.

**625 MIJË EURO PËR SPORTISTËT
DHE TRAJNERËT E KOSOVËS**

F. 11

25 VJET PAS 11 SHTATORIT, A MUND TË KTHEHET AFGANISTANI NË STREHË TË TERRORIZMIT GLOBAL?

UASHINGTON, 9 SHTATOR - Njëzet e pesë vjet pasi sulmet e 11 Shtatorit u planifikuan nga Al-Kaida në Afganistan, ky vend duket se është kthyer sërish në pikën e nisjes: talibanët janë në pushtet, pas 20 vjetësh prani ushtarake të udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara, ndërsa operativë të Al-Kaidës kanë rigjetur strehën atje.

Deri më tani, kjo nuk ka çuar në sulme të mëdha terroriste në kryeqytetet perëndimore, të planifikuara nga Afganistani, e aq më pak në diçka të përmasave të sulmeve të 11 Shtatorit.

Por, ish-zyrtarë ushtarakë, diplomatikë dhe të inteligjencës, si dhe ekspertë të rajonit, japin vlerësime të ndryshme për Radion Evropa e Lirë se përse kjo nuk ka ndodhur.

Disa argumentojnë se situata sot është thelbësisht ndryshe nga ajo para 11 Shtatorit. Të tjerë paralajmërojnë për një kërcënim në ringjallje dhe për një “bombë me sahat”.

Pas sulmeve të 11 Shtatorit, Uashingtoni vendosi të mbështeste një aleancë forcash kundër talibanëve për t'i larguar ata nga pushteti dhe për të gjurmuar udhëheqësit e Al-Kaidës që ndodheshin në Afganistan.

Por, kjo ndërhyrje u shndërrua në një luftë 20-vjeçare, me kosto të jashtëzakonshme financiare dhe njerëzore.

Në vitin 2020, gjatë mandatit të parë të Donald Trumpit si president i SHBA-së, u nënshkrua një marrëveshje me talibanët, sipas së cilës forcat ndërkombëtare do të tërhiqeshin, ndërsa talibanët zotoheshin se “nuk do të lejonin asnjë prej anëtarëve të tyre, individëve apo grupeve të tjera, përfshirë Al-Kaidën, ta përdornin territorin e Afganistanit për të kërcënuar sigurinë e Shteteve të Bashkuara dhe aleatëve të tyre”. Sipas marrëveshjes, talibanët u zotuan, gjithashtu, të mos lejonin “rekrutimin, trajnimin dhe mbledhjen e fondeve” nga grupe apo individë të tillë.

Rikthimi i Al-Kaidës

Tërheqja e forcave ndërkombëtare përfundoi në vitin 2021, gjatë presidencës së Joe Bidenit.

Që atëherë, raporte të shumta të ekipeve të Kombeve të Bashkuara që monitorojnë sanksionet, kanë dokumentuar rikthimin e pjesëtarëve të Al-Kaidës në Afganistan.

Një raport i tillë, i publikuar në dhjetor të vitit 2025, e përshkroi Afganistanin si “atdheun simbolik” të grupit dhe vuri në dukje “marrëdhëniet personale



dhe martesat” mes pjesëtarëve të Al-Kaidës dhe talibanëve. “Afganistani tashmë po strehon terroristë që kanë synime ndërkombëtare. Pyetja e radhës është nëse do të përpiqen t'i realizojnë ato. Por, a është kthyer Afganistani aty ku ishte para 11 Shtatorit? Po”, thotë për Radion Evropa e Lirë ish-diplomatja amerikane, Annie Pforzheimer.

Pforzheimer ishte zëvendëshefe e misionit amerikan në Kabul në periudhën 2017-2018 dhe ushtruese e detyrës së zëvendësndihmëssekretares amerikane të Shtetit për çështjet afgane në periudhën 2018-2019. “Unë e shoh këtë si kërcënim të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë për pjesën tjetër të botës”, thotë ajo. “Al-Kaida është ende atje dhe, duke pasur parasysh historinë e saj, mbetet jashtëzakonisht e fuqishme”, sipas saj.

Gjenerali H.R. McMaster, i cili shërbeu si këshilltar për siguri kombëtare i SHBA-së në periudhën 2017-2018, ndan shqetësimet e Pforzheimerit. Ai thotë për Radion Evropa e Lirë se pritja që talibanët t'i përmbaheshin marrëveshjes, ishte “vetëmashtrim”. “Ata janë organizatë terroriste. Ajo që duhet të bëjmë është ta dobësojmë qeverinë terroriste në Afganistan”, thotë ai.

Pforzheimer dhe McMaster theksojnë se Al-Kaida nuk është grupi i vetëm i rrezikshëm që vepron në Afganistan me

bekimin e talibanëve.

Raportet e OKB-së kanë evidentuar, gjithashtu, bashkëpunimin e Al-Kaidës me Tehrik-e Taliban Pakistanin (TTP) për kryerjen e sulmeve ndërkufitare në Pakistan.

Edhe militantë të Shtetit Islamik janë të pranishëm në Afganistan dhe kanë kryer sulme atje dhe në Pakistan.

Colin Clarke, drejtor ekzekutiv i Qendrës Soufan, një institut me seli në Nju Jork që merret me çështje të sigurisë, e përshkruan situatën në Afganistan si një përzierje të rrezikshme grupesh që i ngjan një “bombe me sahat”.

“Përvoja e 11 Shtatorit”

Por, ekspertë të tjerë bëjnë thirrje për kujdes në vlerësimin e kërcënimit.

Shumëcka ka ndryshuar që nga 11 Shtatori, madje edhe që nga rikthimi i talibanëve në pushtet në Afganistan.

Talibanët tani kërkojnë në mënyrë aktive bashkëpunim ndërkombëtar.

Së fundmi, ata dërguan një delegacion për takim me Bashkimin Evropian në Bruksel, ndërsa Rusia i ka njohur si qeveri legjitime e Afganistanit. Përpjekjet e tyre për afrim janë pritur ftohtë në Perëndim, për shkak të kufizimeve të ashpra ndaj të drejtave të grave dhe shkeljeve të tjera të të drejtave të njeriut.

Megjithatë, disa ekspertë besojnë se udhëheqja talibane

sot ushtron kontroll më të madh mbi grupe si Al-Kaida sesa në të kaluarën.

“Një dallim i madh krahasuar me periudhën para 11 Shtatorit është se talibanët e kanë përjetuar 11 Shtatorin dhe pasojat që ai solli. Prandaj, duhet të besoj se ata po vëzhgojnë me shumë kujdes se çfarë po bëjnë këta pjesëtarë të Al-Kaidës”, thotë për Radion Evropa e Lirë Jonathan Schroden, drejtues i kërkimeve në CNA, një institut me seli në Uashington.

Schroden, i cili po përfundon një libër mbi historinë e operacioneve amerikane kundër terrorizmit në Afganistan, thotë se ky vend nuk është më epiqendra e kërcënimit. “Nëse sot synoni t'i luftoni degët më të rrezikshme të Al-Kaidës, ato gjenden në Afrikë, qoftë Al-Shabaab, qoftë grupet e ndryshme në Afrikën Perëndimore që janë të lidhura me Al-Kaidën. Ato janë më aktivet dhe më të dhunshmet”, thotë ai.

Strategjia më e fundit amerikane kundër terrorizmit, e publikuar në maj, gjithashtu vë theksin te kërcënimet që vijnë nga këto dhe rajone të tjera.

Schroden nuk është i vetmi që e vlerëson në këtë mënyrë situatën në Afganistan.

Carter Malkasian, ish-asistent i posaçëm për strategji i kryetarit të Shefave të Shtabit të Përbashkët dhe tani në Kolegjin Kombëtar të Luftës,

shkroi së fundmi në Foreign Affairs se “mungesa e terrorizmit” pas pesë vjetësh të sundimit taliban, është tregues se gjërat në Afganistan kanë ndryshuar.

Malkasian, i cili shërbeu si zyrtar politik në provincën Helmand në periudhën 2009-2011, vë në pikëpyetje raportimet e OKB-së, duke thënë se “ka pak dëshmi që sugjerojnë se Al-Kaida po organizohet, po mbledh fonde apo po zhvillon trajnime në territorin afgan”.

Megjithatë, ai pranon se informacionet e inteligjencës janë të kufizuara. “Aftësia e Uashingtonit për ta monitoruar Afganistanin nuk është ajo që ishte në vitin 2020, e aq më pak në vitin 2011. Shtetet e Bashkuara mund të mos jenë në gjendje të zbulojnë planifikimin e sulmeve terroriste apo trajnimet në fshatrat malore ose në rrugicat e Kabulit, Kandaharit apo Xhalalabadit”, shkruan ai.

Këtë pikë e ngre edhe Schroden, i cili vëren se SHBA-ja nuk ka kryer asnjë sulm në Afganistan që nga viti 2022, kur vrau në Kabul udhëheqësin e atëhershëm të Al-Kaidës, Ayman al-Zawahri. “Ose SHBA-ja ka aq pak informacion për atë që po ndodh atje, sa që nuk mund të identifikojë objektiva për t'i goditur, ose në Afganistan sot, thjesht, nuk ka objektiva të rëndësishme të llojit që kishte dikur”, përfundon Schroden.

A MUND HAXHIU TA USHTROJË DETYRËN E PRESIDENTIT EDHE PËR GJASHTË MUAJ TË TJERË?

PRISHTINË, 9 SHTATOR - Në më pak se një muaj, Kosova mund të përballet me një gjendje të pasigurt kushtetuese, nëse deri më 4 tetor nuk zgjidhet presidenti i ri i shtetit. Ekspertë ligjorë thonë se kryeparlamentari nuk mund ta vazhdojë këtë detyrë përtej këtij afati gjashtëmuajor. Ushtruesja e tanishme e kësaj detyre, Albulena Haxhiu, u rizgjodh kryetare e Kuvendit të Kosovës më 9 shtator, ndërsa më herët nga partia e saj, Lëvizja Vetëvendosje në pushtet, është hedhur ideja se kryetarja e re e Kuvendit mund ta vazhdojë edhe një gjashtëmuajor të dytë në rast nevoje. Edhe Presidenca - të cilën e udhëheq Haxhiu që nga 4 prilli, kur presidentes së deriatëhershme, Vjosa Osmani, i mbaroi mandati - ka thënë se kryetarja e re e Kuvendit do të vazhdonte ushtrimin e detyrës së presidentit deri në zgjedhjen e presidentit të ri.

A mund ta vazhdojë detyrën Haxhiu përtej 4 tetorit?

Jo, thonë disa ekspertë ligjorë, me të cilët bisedoi Radio Evropa e Lirë. Posti i ushtruesit të detyrës së presidentit të Kosovës nuk mund të ushtrohet për një periudhë më të gjatë se gjashtë muaj, sipas Kushtetutës. Vullnet Bugačku nga Instituti Demokratik i Kosovës vlerëson se Haxhiut, si kryetare e Kuvendit, mandati si ushtruese e detyrës së presidentit i

përfundon më 4 tetor. “Pas kësaj date skadon afati i gjashtëmuajor dhe ligjërisht i njëjti ose e njëjta nuk ka të drejtë që të funksionojë edhe si ushtrues i detyrës së presidentit, për shkak se është në kundërshtim me nenin 90, paragrafin 3, të Kushtetutës së Kosovës”, tha Bugačku për REL-in të mërkurën, pasi Haxhiu u rizgjodh kryeparlamentare. Sipas Bugaçkut, çdo vendim apo dekret që mund të nxirret pas kësaj date nga Haxhiu është i kontestueshëm për nga kushtetutshmëria, dhe rrezikon të rrëzohet nga gjykatat. Ai thotë se deputetët duhet ta shohin si alarmues afatin kohor deri më 4 tetor për zgjedhjen e presidentit. Haxhiu e ndërpreu seancën konstituive të mërkurën, duke e shtyrë për të premtën vazhdimin e saj për përmbylljen e konstituimit të Kuvendit.

Ajo tha se nuk kishte pajtueshmëri për mënyrën e votimit të nënkryetarëve dhe se deputeti i Listës Serbe, Igor Simiq, dështoi ta tërhiqte fjalën “në emër të popullit serb”, kur e propozoi kandidatin për nënkryetar nga komuniteti serb. Ndërkohë, drejtori ekzekutiv i Institutit të Kosovës për Drejtësi, Ehat Miftaraj, thotë për REL-in se Kushtetuta e Kosovës e lidh kufizimin gjashtëmuajor me ushtrimin e postit të presidentit, e jo me personin që e ushtron atë. Sipas Miftarajt, për këtë arsye, ndryshimi i personit që e



ushtron detyrën e presidentit, apo rizgjedhja e kryetarit të Kuvendit, nuk mund të ketë efektin e fillimit të një afati të ri gjashtëmuajor. “Një interpretim i tillë do të mundësonte që, përmes ndryshimit të personit, gjendja e ushtrimit të detyrës së Presidentit të vazhdonte përtej kufirit prej gjashtë muajsh të përcaktuar shprehimisht me Kushtetutë”, thekson ai.

“Tejkalimi i 4 tetorit pa një president të ri cenon sigurinë e shtetit”

Bugačku shton se, për shtetin dhe sistemin kushtetuese parlamentar në Kosovë, tejkalimi i afatit të 4 tetorit do të thotë “një njollë shumë e keqe dhe një precedent i rrezikshëm që cenon edhe sigurinë kombëtare”. Më 4 tetor përfundon periudha gjashtëmuajore gjatë së cilës, sipas Kushtetutës, postin e presidentit të Kosovës mund ta mbajë një ushtrues detyre.

Deputeti i LV-së, Adnan Rustemi, kishte thënë më herët për REL-in se pozita e ushtruesit të detyrës së presidentit “është e varur nga pozita e kryetarit të Kuvendit”. Sipas tij, pas zgjedhjes, kryetari i ri i Kuvendit nis ushtrimin e detyrës së presidentit deri në zgjedhjen e presidentit. Afati prej gjashtë muajsh, i përcaktuar nga Kushtetuta, nis të rrjedhë nga fillimi, me zgjedhjen e kryetarit të ri të Kuvendit, pretendoi ai. “Është në frymën dhe përmbajtjen, por edhe në funksionin e Kushtetutës, që të garantojë vazhdimësi institucionale. Asnjëherë, e për asnjë arsye, vendi nuk mund të mbetet pa president apo pa ushtrues detyre të presidentit. Vakum institucional nuk mund të ketë në asnjë rrethanë”, deklaroi Rustemi për REL-in. Më herët, Eugen Cakolli, hulumtues në Institutin Demokratik të Kosovës, i kishte thënë REL-it se periudha gjashtëmuajore për ushtrimin e detyrës së presidentit përbën afat absolut, dhe si i tillë nuk

mund të përsëritet në asnjë skenar. Moszgjedhja e presidentit të ri, deri më 4 tetor, sipas Cakollit, përbën skenarin më të rrezikshëm kushtetues me të cilin mund të ballafaqohet Kosova. “Në një situatë të tillë, vendi do të hynte në një terren kushtetues, i cili, përveçse do të ishte serioz dhe i rrezikshëm, do të duhej medoemos të kishte parashtrësë në Gjykatën Kushtetuese”, theksoi ai. Melos Kolshi, hulumtues ligjor në Institutin e Kosovës për Drejtësi, i tha REL-it se pas 4 tetorit, çdo vazhdim i ushtrimit të detyrës së presidentit do të ishte pa bazë kushtetuese, dhe do të cenonte seriozisht rendin kushtetues. Partitë opozitare shqiptare nuk janë deklaruar për këtë çështje publikisht. Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca nuk iu përgjigjën as pyetjeve të REL-it rreth kësaj çështjeje. Çështja e zgjedhjes së presidentit ka qenë në zemër të krizës politike në vend dhe shkaktoi zgjedhje të reja parlamentare në qershor. Një marrëveshje e brishtë mes LV-së dhe LDK-së për kandidaturën e diplomatit dhe juristit kosovar, Bekim Sejdiu, nuk duket ta ketë mbështetjen e nevojshme, pasi edhe deputetë nga vetë LDK-ja e kanë kundërshtuar publikisht. Nevojitet prania e 80 deputetëve në Kuvendin me 120 vende që votimi për presidentin e Kosovës të jetë i vlefshëm. LV-ja ka 53 mandate, ndërsa LDK-ja 18.

AKB-ja NË PARLAMENTIN EVROPIAN: SEKTORI PRIVAT I KOSOVËS DUHET TË PËRFITOJË MË SHUMË NGA PLANI I RRIJTJES

Bruksel, 9 shtator- Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), Agim Shahini, është pritur në Parlamentin Evropian, ku temë kryesore e diskutimit ishte Plani i Rritjes për Ballkanin Perëndimor dhe përfshirja e sektorit privat të Kosovës në fondet dhe mundësitë financiare që ofron Bashkimi Evropian. Në këtë takim u theksua rëndësia që bizneset kosovare të kenë qasje më të drejtpërdrejtë dhe më të lehtë në fondet evropiane, pasi sektori privat është një nga motorët kryesorë të rritjes ekonomike, punësimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të Kosovës. AKB-ja vlerëson se fondet e Planit të Rritjes nuk duhet të mbeten vetëm në projekte institucionale, por duhet të krijojnë mundësi konkrete për



kompanitë private, përmes investimeve, kredive të favorshme, garancive financiare, inovacionit, digjitalizimit, energjisë së pastër, prodhimit dhe rritjes së eksporteve. Sipas AKB-së, Plani i Rritjes është një mundësi historike për

Kosovën, por kjo mundësi nuk duhet të kalojë pa biznesin. Sektori privat duhet të jetë pjesë e drejtpërdrejtë e përfitimit nga fondet evropiane. “Ne nuk kërkojmë privilegje, por kushte të barabarta, transparencë dhe mundësi reale për kompanitë kosovare”, ka thënë kryetari i

AKB-së, Agim Shahini, duke theksuar se përfshirja e sektorit privat duhet të jetë një prioritet kryesorë të politikave ekonomike të Kosovës në raport me Bashkimin Evropian. Sipas AKB-së, kompanitë kosovare duhet të kenë mundësi të përfitojnë nga këto instrumente për të rritur kapacitetet prodhuese, për të investuar në teknologji, për të hapur vende të reja pune dhe për të hyrë në zinxhirët evropianë të furnizimit. “Nëse synojmë rritje ekonomike, atëherë duhet të investojmë te biznesi. Nëse synojmë integrim evropian, atëherë biznesi kosovar duhet të jetë pjesë e tregut dhe e fondeve evropiane. Plani i Rritjes duhet të ndihet në çdo kompani që ka potencial për të prodhuar, eksportuar dhe punësuar”, u shpreh Shahini.

AKB-ja kërkon nga institucionet e Kosovës dhe partnerët evropianë që të ndërtojnë mekanizma të qartë, transparentë dhe të qasshëm për sektorin privat, në mënyrë që fondet evropiane të mos shfrytëzohen vetëm nga institucionet publike, por të ndikojnë drejtpërdrejt në fuqizimin e ekonomisë së Kosovës. Shahini ka thënë se AKB-ja do të vazhdojë të kërkojë që biznesi kosovar të jetë partner në procesin e integritimit evropian dhe përfitues aktiv i mundësive që sjell Plani i Rritjes. Mesazhi i AKB-së nga Brukseli ishte se pa sektor privat të fuqishëm nuk ka rritje ekonomike, ndërsa pa përfshirjen e biznesit nuk ka integrim të plotë ekonomik evropian.



HAXHIU ZGJEDHET KRYEPARLAMENTARE, POR VETËVENDOSJE BLOKON KONSTITUIMIN E PLOTË TË KUVENDIT

Deputetët e Kuvendit të Kosovës rizgjodhën të mërkurën Albulena Haxhiun në postin e kryetares së Kuvendit, por nënkryetarët nuk u hodhën në votim. Ligjvënësit shfaqën mospajtime lidhur me mënyrën e votimit të nënkryetarëve. Pengesë u bë edhe formulimi i përdorur nga Lista Serbe, e cila propozoi Sllavko Simiqin për postin e nënkryetarit. Formulimi “në emër të popullit serb” u konsiderua jokushtetues nga kryetarja Haxhiu, e cila e shtyu seancën për të premtën. Ndërkohë, partitë parlamentare PDK dhe LDK kanë drejtuar akuza ndaj LV-së, duke e bërë përgjegjëse për bllokimin e konstituimit të plotë të Kuvendit

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 9 SHTATOR - Deputetja Albulena Haxhiu është zgjedhur të mërkurën kryetare e Kuvendit e legjislaturës së njëmbëdhjetë. Ajo mori 62 vota për, 16 kundër, ndërsa 13 veta abstenuan. Haxhiu, e cila ushtron edhe postin e presidentit nga 4 prilli, do të vazhdojë edhe më tutje këtë detyrë deri në zgjedhjen e presidentit të ri. Albulena Haxhiu ishte edhe kryetare e legjislaturës së dhjetë e cila u shpërnda më 1 korrik 2026. Pastaj seanca vazhdoi me propozimin e nënkryetarëve të Kuvendit. LV-ja e ka propozuar Ardian Golën, PDK-ja Vlora Çitakun, LDK-ja Kujtim Shalën, Lista Serbe Sllavko Simiqin, ndërsa komuniteti joserb e

propozoi Emilia Rexhepin. Por në këtë pikë u shfaqën mospajtime rreth formës së votimit për nënkryetarët. Haxhiu tha se partitë parlamentare kanë mospajtime sesi të votohet. Sipas saj, disa duan që të votohen të gjithë në pako, e disa jo. “Prandaj edhe i ftoj grupet parlamentare që të vijnë në zyrën time. Në ndërkohë, kërkoj nga administrata e Kuvendit që të na njoftojë me formën e propozimit të Listës Serbe për nënkryetar të Kuvend, në qoftë se është në linjë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës apo jo. Pra, këtë konfirmim e marrim pas pak. Nëse nuk është në linjë me Kushtetutën, natyrisht që zbatohet rregullorja e Kuvendit”, tha ajo, pasi ndërpreu seancën për 30 minuta. Haxhiu u takua me përfaqësuesit

e partive parlamentare për të arritur një marrëveshje për mënyrën e votimit, por takimi mbaroi pa marrëveshje. “Pra, në atë takim, siç unë e kuptova, ishte e qartë që as propozimi i grupit parlamentar, përkatësisht subjektit politik PDK, që ishte zonja Vlora Çitaku dhe në anën tjetër as propozimi i LDK-së që ishte Kujtim Shala, nuk i kanë votat”, tha Haxhiu. Herën e fundit të gjitha pesë nënkryetarët ishin votuan në pako, pas një marrëveshjeje paraprake mes partive. Ndërkaq gjatë vazhdimit të seancës, kryetarja e Kuvendit, Albulena Haxhiu, i ka tërhequr vërejtjen deputetët të Listës Serbe, Igor Simiq, për mënyrën e propozimit të kandidatit për nënkryetar nga kjo parti, pasi ai tha se propozimin e bën në “emër

të popullit serb”.

Haxhiu i ka kërkuar që ta tërheqë këtë formulim dhe ta ribëjë propozimin, pasi, sipas saj, një deklaram i tillë është në kundërshtim me Kushtetutën. “Popull serb ka në Serbi, ndërsa Republika e Kosovës ka popullin e Kosovës”, i tha Haxhiu. Simiq iu përgjigj se “e kupton lojën që po luajnë” dhe se, në përputhje me Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, propozimet për nënkryetarin nga radhët e komunitetit serb, “siç thoni ju, dorëzohen me shkrim. Ju e keni marrë atë më 6 gusht”. Haxhiu më pas e ndërpreu Simiqin dhe kërkoi prej tij që ta tërhiqte formulimin që kishte përdorur më herët, “në emër të popullit serb”, dhe të vazhdonte me propozimin për nënkryetar. Simiq u përgjigj: “Unë jam pjesëtar i popullit serb dhe këtë të drejtë nuk do të ma merni”. Pas kësaj, Haxhiu kërkoi sërish që t’i ndërpritej fjala. Kryetarja e Kuvendit duke e parë situatën e përgjithshme gjatë seancës, shtyri për të premtën vazhdimin e seancës për konstituimin e Kuvendit, duke thënë se “nuk ka vota për nënkryetarët pa një marrëveshje

paraprake” për mënyrën e votimit.

Haxhiu tha se po e shtyn seancën për të premtën në orën 11:00, gjithashtu pasi deputeti i Listës Serbe, Igor Simiq, nuk e tërhoqi fjalinë “në emër të popullit serb” kur e propozoi kandidatin e partisë për nënkryetar nga komuniteti serb. “Rregullorja e Kuvendit parasheh saktë se cilat janë masat që duhet të ndërmerren ndaj deputetëve që përdorin gjuhë të tillë në Kuvendin e Republikës së Kosovës”, tha Haxhiu pasi Simiq refuzoi ta tërheqë fjalinë.

Kurti i fton Hamzën dhe Abdixhikun në takim për nënkryetarët e Kuvendit

Kryeministri në detyrë, njëherësh kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, i ka ftuar në takim kryetarin e PDK-së, Bedri Hamza dhe atë të LDK-së, Lumir Abdixhiku, për të biseduar për votimin e nënkryetarëve të Kuvendit. Në një deklaram për media, pas ndërprerjes së seancës konstituive, Kurti tha se dakordimi me Hamzën e Abdixhikun për nënkryetarët është i rëndësishëm.

“Unë tashmë jam në kontakt, përveçse me kryetarin e LDK-së gjithashtu i kam shkruar edhe atij të PDK-së, që të takohemi dhe në këtë mënyrë të kemi dakordim edhe për përzgjedhjen e nënkryetarëve meqenëse nevojitet mbështetja e mazhorancës edhe për propozimet e tyre”, tha ai Kurti shtoi: “Le të jemi pozitiv e konstruktiv dhe në këtë mënyrë të kemi Kuvend të konstituar, shpejt qeveri të formuar dhe të kalojmë te zgjedhja e presidentit, që duhet të bëhet në mënyrë që t'i evitojmë zgjedhjet e reja”.

Sipas Kurtit, mënyra e propozimit të nënkryetarit nga Lista Serbe nuk ka qenë në përputhje me Kushtetutën. “Për mua ishte e çuditshme pse ai nuk e lexoj saktësisht siç e ka deponuar me shkrim propozimin për Slavko Simiqin. Pra propozimin me shkrim që e ka bërë kur ka kërkuar që nënkryetar i Kuvendit nga radhët e Listës Serbe të jetë Slavko Simiqi e ka shkruar në përputhje me Kushtetutën, por atë çfarë e deklaroi ai ishte në shpërputhje flagrante”.

Nagavci për PDK-në dhe LDK-në: Kërkojnë votë për nënkryetarët, por kundërshtojnë presidentin

Deputetja e LV-së, Arbërie Nagavci kritikoi deklaratën e deputetit të Listës Serbe, Igor Simiq, gjatë propozimit të nënkryetarit nga radhët e komunitetit serb. Nagavci tha se propozimi “në emër të popullit serb” ashtu sikurse mos pajtimi për mënyrën e votimit të nënkryetarëve bëri që seanca të shtyhet për të premten. Sipas saj është e paarsyeshme që 53 deputetë të LV-së t'i japin votën bllanko për nënkryetarë

atyre që kanë vendosur ta çojnë vendin në zgjedhje. “Ndërkohë që kërkojnë votë për nënkryetarë, kemi edhe deklarata të tyre që nuk e votojnë kandidatin për president”, tha Nagavci për kandidatët e PDK-së dhe LDK-së Sipas saj për LV-në është shumë e rëndësishme që të ketë edhe konstituimin e Kuvendit edhe zgjedhje të presidentit sa më shpejt.

Gruda: LV-ja po shpik probleme për të mos e konstituuar Kuvendin

Deputeti i PDK-së, Përparim Gruda, ka thënë se Lëvizja Vetëvendosje është duke krijuar pengesa pasi nuk dëshiron ta konstituojë Kuvendin. Në deklarinimin për media, pas ndërprerjes së punimeve të seancës, ai tha se bllokada e radhës është një lojë tjetër politike e LV-së. Gruda tha se PDK-ja voton për zgjedhjen e nënkryetarëve të Kuvendit në çfarëdo forme, vetëm që të konstituohet Kuvendi. “PDK-ja voton në çdo formë, çdo procedurë sepse është një moment historik, është ngjarja e 16 shtatorit. Ne nuk mund të mos kemi Kuvend më 16

shtator. Kjo është e paprecedentë, kjo nuk ka ndodhur në asnjë vend normal demokratik që të shpiken lloj-lloj pengesash për të mos e konstituuar Kuvendin”. Gruda po i referohej 16 shtatorit, ditës kur Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë do ta shpallin aktgjykimin ndaj ish-krerëve të UÇK-së. Në lidhje me prezantimin e kandidatit të nënkryetarit nga Listës Serbe, deputeti i PDK-së tha se ata kanë përdorur mënyrën e njëjtë edhe në vitin e shkuar edhe në vitin 2021.

Lushaku: Kuvendi nuk po konsolidohet për fajin e LV-së

Deputetja e LDK-së, Jehona Lushaku e ka fajësuar LV-në për mos përmbylljen e e konstituimit të Kuvendit. Sipas saj “grupi më i madh parlamentar po harron që jemi jashtë afateve kushtetuese” për të konsoliduar Kuvendin e Kosovës. Lushaku e quajti të paprecedentë këtë situatë kur konstituimi nuk përmbyllet nga mospajtueshmëria për mënyrën se si të votohen 5 nënkryetarët e Kuvendit.

Simiq akuzon Kurtin për zvarritje të formimit të institucioneve

Nënkryetari i Listës Serbe, Igor Simiq, në një postim në “Instagram”, akuzoi kryeministrin në detyrë, Albin Kurti, se po e zvarrit formimin e institucioneve me synimin, sipas tij, që zgjedhjet e parakohshme të mbahen në dhjetor, kur mund të llogarisë edhe në votat e diasporës. Simiq tha se Kushtetuta dhe Rregullorja e Kuvendit përcaktojnë se një nga postet e nënkryetarit të Kuvendit i takon komunitetit serb. Ai tha gjithashtu se e braktisi takimin konsultues të thirrur nga kryetarja e Kuvendit, Albulena Haxhiu, pasi, sipas tij, nuk ishte siguruar përkthim në gjuhën serbe.

Dështimi i konstituimit të Kuvendit, Gjini: Skenar i planifikuar nga Kurti dhe Lista Serbe

Kryetari i Aleancës, Ardian Gjini, ka reaguar pas dështimit të seancës konstituive të Kuvendit të Kosovës, duke e cilësuar situatën si një skenar të parapërgatitur për zvarritjen e proceseve politike në

vend. Gjini tha se Aleanca kishte paralajmëruar prej kohësh se Kuvendi nuk do të arrinte të konstituohej, ndërsa akuzoi Lëvizjen Vetëvendosje dhe kryeministrin në detyrë, Albin Kurti, për koordinim me Listën Serbe. “A ju kemi thënë që nuk kanë për ta konstituuar Kuvendin sot?”, deklaroi Gjini para gazetarëve. Sipas tij, Lista Serbe, me ose pa koordinim po ndihmon Kurtin që ta zhvillojë agjendën e tij politike. “Kush e di për të satën herë, me koordinim apo pa koordinim, Lista Serbe po ndihmon që Albin Kurti ta zhvillojë agjendën e vet qysh i konvenon. Është një maskradë për ta zvarritur procesin ashtu siç u përshtatet atyre”, tha ai. Gjini theksoi se vendimi i Aleancës për të mos u bërë pjesë e këtij procesi tashmë është dëshmuar, duke u bërë thirrje edhe dy partive të tjera opozitare që të mos marrin pjesë në atë që ai e quajti “maskradë”. Ai tha se skenari për zvarritjen e procesit ishte i qartë që nga korriku, kur partia fituese e zgjedhjeve refuzoi ofertën e Aleancës. “Prej korrikut ju kam treguar që kjo ka për të ndodhur. Partia që ka dalë e para nga zgjedhjet ka refuzuar të merret me ofertën tonë. Vetë fakti që kanë refuzuar, ka treguar që ky ka qenë qëllimi”, u shpreh Gjini. Duke folur për zhvillimet e mëtejshme, Gjini përmendi edhe kalkulimet me afatet ligjore, të cilat, sipas tij, mund të çojnë vendin drejt zgjedhjeve të reja në fund të vitit. “Duhet të mbërrihet së paku data 30 shtator, në mënyrë që kur të kalkulohet edhe 60-ditëshi, edhe 45 ditë deri në shkuarjen në zgjedhje, partia që i ka fituar zgjedhjet e kaluara ta mbërrijë datën 27 dhjetor”, tha ai. Gjini argumentoi se zgjedhjet e reja janë të nevojshme, pasi sipas tij qeverisja aktuale ka humbur besimin e qytetarëve.

Cakolli: Synimi që nga fillimi ka qenë moskonstituimi i Kuvendit

Eugen Cakolli nga KDI ka kritikuar zhvillimet e fundit rreth konstituimit të Kuvendit të Kosovës, duke thënë se nuk pritej që procesi të përmbyllej me sukses pas, siç tha ai, shkeljes së qëllimshme të afateve kushtetuese dhe zvarritjes për më shumë se një muaj. Cakolli ka deklaruar se, sipas tij, synimi që nga fillimi ka qenë moskonstituimi i Kuvendit, së paku derisa të sigurohej që, në rast të shkuarjes në zgjedhje, ato të mbaheshin më 27 dhjetor ose 3 janar. “Synimi prej fillimit ka qenë qartazi moskonstituimi i Kuvendit”, ka shkruar Cakolli në “Facebook”, duke shtuar se zhvillimet e tjera, përfshirë ato të së mërkurës, janë “taktizime politike” që i shërbejnë këtij qëllimi. Ai ka theksuar se për këtë arsye rasti është dashur të dërgohet në Gjykatën Kushtetuese, pasi, sipas tij, vetëm një pasojë e qartë juridike do të mund ta parandalonte “zhvlerësimin e institucionit kryesor në vend”.



LIRIA NUK GJYKOHET...

Shkruan:
Pandeli MAJKO

Urim për pafajësinë e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit është sot edhe një peshë! Ky urim rëndon, pasi ai ka përballë të paparashikueshmen! Besimi në diçka, nuk e bën atë, të vërtetë!

Gjykimi në Hagë po futet në protokollet e fundit përpara shpalljes së vendimit më 16 shtator 2026!

Pritshmëria për vendimin e Hagës është e ndarë në atë shqiptare dhe në atë serbe! Për fat të keq, gjykimet e Hagës kanë prodhuar këtë ndjesi edhe për kombet e tjera! Në çdo rast, në njërën krah qëndrojnë boshnjakët, kroatët dhe shqiptarët kurse përballë tyre janë serbët!

“Teknika” e gjyqimeve ndërkombëtare të Hagës për ti shpallur fajtorë që të gjithë, për luftën që shkatërroi Jugosllavinë, nuk kanë krijuar pajtimin e pritshëm! E kundërta është e vërtetë! Ceremonia shtetërore në Serbi, për kriminelin e luftës Ratko Mladić që vdiq në burgun e Hagës, ishte tregues se drejtësia ndërkombëtare nuk u konsiderua e tillë!

Ballkani ka qenë një tokë ku veset janë kthyer në rregulla!



Me rastin e daljes së vendimit gjyqësor në Hagë shpresa e politikës antishqiptare dhe “prestanomeve” të tyre, është pritshmëria për një “kryengritje” pakënaqësie shqiptare ndaj Perëndimit! Kjo pritshmëri antishqiptare po e nxit këtë ide të bazuar në mundësinë e dënimit të drejtuesve të UÇK-së në gjykatën e Hagës!

Kjo “kryengritje” po aludohet

ngadalë, por bindshëm! Strategjia në fjalë shpreson që zemërimi shqiptar karshi një gjykate ndërkombëtare ti tregojë ata (shqiptarët) si faktor antiperëndim! Duke filluar nga Beogradi, edhe të tjerë, presin që një “vendim negativ” i gjykatësve të Hagës ta barazojë atë si qëndrim i Perëndimit karshi shqiptarëve! Kosova mund të ndodhet përballë një manipulimi masiv i

cili mund të sjelli dëme jo të vogla!

Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi nuk do të pranonin që emri i UÇK-së, jetët e humbura në luftën çlirimtare dhe emri i tyre të përdoshin si ARMË kundër Perëndimit!

Në se ndodh skenari negativ, ai është prova e rëndë që kombi shqiptar do të kalojë në marrëdhënie me Perëndimin! Shqiptarët, pa Perëndimin, janë Jetimë!

Kjo ka ndodhur një herë, në konferencën e ambasadorëve në 1913!...

Përsëritja e historisë do të jetë që Serbia me Rusinë pas, të negociojë me Perëndimin, “kryengritjen” shqiptare!

Beogradi po pret vendimin e Hagës dhe ka rritur presionin! Presidenti i Serbisë Aleksandër Vuçiq nuk i fsheh pritshmëritë serbe kur deklaroi se “Perëndimi dëshiron të thotë se ne jemi të vetmit fajtorë dhe se duhet ta pranojmë këtë, sepse nuk ka pasur krime ndaj jush. Gjaku serb nuk ka rëndësi!” (Vini re që Vuçiq lidh vendimin e Hagës me qëndrimin e Perëndimit!...)

Pozitën serbe sot e shpejgon Dobrica Qosiç i konsideruar si “ati i kombit serb”! Ai në romanin e tij “Deobe” (1961) shkroi fragmentin e njohur: “Gënjeshtër është interes shtetëror serb... Ne gënjejmë

për të gënjer veten, për të ngushëlluar tjetrin; gënjejmë nga mëshira, gënjejmë nga turpi, për t'u inkurajuar, për të fshehur mjerimin tonë dhe të tjerëve... Gënjeshtër është formë e patriotizmit tonë dhe provë e inteligjencës sonë të lindur.”...

Politika e Beogradit zyrtar pret që gjykata e Hagës ta shpallë gënjeshtër e tyre si të vërtetë! Vendimi i Hagës për shqiptarët, është një çast historik kur e kaluara kërkon diçka nga tashmja!

Historia për shqiptarët ka qenë altar i ushqyer me dhimbje dhe sakrificë!

Ajo nuk është shkruar në... gjykatë, por ka kaluar nga ajo! Historia shqiptare i ngjan një seance të zgjatur gjyqësore! Kjo seancë ka nisur në vitin 1878 në Lëvizjen e Prizrenit! Të akuzuarit fillojnë nga Abdyl Frashëri, Isa Buletini, Ali Ibra...!

Përballë vendimit të gjykatës, këshilla më e mirë e traditës shqiptare është të flasësh vetëm kur je i sigurt që ajo që do të thuash është më e mirë se sa heshtja!

Në Hagë sot, janë të burgosur, katër shqiptarë që kanë bërë betimin “... do të jem përherë ushtar besnik, luftëtar i denjë...”

Mospëlqimi i frikacakëve është lavdia e trimave!

Liria e një populli nuk gjykohet!

MYFTIU TËRNAVA DHE IPESHKVI DODË GJERGJI NË MBËSHTETJE TË MARSHIT PËR LIRI MË 12 SHTATOR

PRISHTINË, 9 SHTATOR - Përfaqësues të platformës qytetare “Liria ka Emër” kanë zhvilluar takim me kryetarin e Bashkësisë Islame të Kosovës, myftiun Naim ef. Tërnavë.



Në takim u diskutua për organizimin e Marshit për Liri, që do të mbahet më 12 shtator, nga ora 14:00, në sheshin “Skënderbeu” në Prishtinë, si dhe për rëndësinë e bashkimit

qytetar në këto ditë vendimtare. Myftiu Tërnavë shprehu mbështetjen e tij për këtë nismë dhe gatishmërinë për të kontribuar në mbarëvajtjen e marshit, duke përcjellë një mesazh solidariteti, uniteti dhe respekti për vlerat e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Platforma “Liria ka Emër” e falënderon Myftiun Tërnavë dhe Bashkësinë Islame të Kosovës për pritjen, mbështetjen dhe solidarizimin. Po ashtu përfaqësuesit e platformës qytetare “Liria ka Emër” kanë zhvilluar takim edhe me ipeshkvin e Ipeshkvisë së Kosovës, Imzot Dodë Gjergji, i cili ka shprehur mbështetjen e tij për Marshin për Liri, duke vlerësuar rëndësinë e unitetit,



solidaritetit dhe qëndrimit të përbashkët në mbështetje të vlerave mbi të cilat është ndërtuar liria e Kosovës. Platforma qytetare “Liria ka Emër” ka falënderuar Ipeshkvin Dodë Gjergji për

pritjen, mbështetjen dhe solidarizimin me këtë nismë qytetare. Marshi për Liri do të mbahet më 12 shtator, nga ora 14:00, në sheshin “Skënderbeu” në Prishtinë.

Instituti i Kosovës për Drejtësi mbështetë “Marshin për Liri”

PRISHTINË, 9 SHTATOR - Përfaqësuesit e platformës Liria ka Emër, Eliza Hoxha, Ismail Tasholli dhe Ridvan Emini kanë zhvilluar një takim me drejtuesit e Institutit të Kosovës për Drejtësi, të cilët kanë shprehur mbështetjen për “Marshin për Liri”, që do të mbahet më 12 shtator në

Prishtinë, në përkrahje të çlirimtarëve që po mbahen në Hagë. Drejtori i IKD-së, Betim Musliu, zëvendësdrejtori Naim Jakaj dhe hulumtuesit Naim Jakaj dhe Qemajl Marmullakaj theksuan se IKD në vazhdimësi ka kërkuar që procesi në Hagë të zhvillohet në mënyrë të drejtë, të

pavarur dhe në përputhje me standardet e gjykimit të drejtë. Në këtë takim, përfaqësuesit e LKE i falënderuan përfaqësuesit e IKD për mbështetjen e ofruar, duke theksuar se Kosova po pret drejtësi, liri dhe kthimin në atdhe të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit.



RRITEN VIZITAT SHËNDETËSORE DHE RASTET E SËMUNDJEVE MALINJE NË KOSOVË

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 9 SHTATOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar Statistikat e Shëndetësisë për vitin 2025, me të dhëna për punësimin në sektorin shëndetësor, sëmundjet, vizitat mjekësore dhe aktivitetet e institucioneve shëndetësore publike e private. Sipas ASK-së, gjatë vitit 2025 numri i vizitave në institucionet shëndetësore është rritur në të gjitha nivelet, përfshirë shëndetësinë primare, sekondare dhe terciare. Rritje më të theksuar është vërejtur në laboratorët e të gjitha niveleve.

Ndërkohë, rastet e reja të personave të prekur nga sëmundjet malinje dhe beninje janë rritur për 3.6 për qind. Nga 3,644 raste të regjistruara në vitin 2024, numri ka arritur në 3,775 raste gjatë vitit 2025.



Mbi 14 mijë të punësuar në sektorin publik

Në sektorin publik shëndetësor, gjatë vitit 2025 kanë qenë të punësuar gjithsej

14,444 persona.

Prej tyre, 3,117 ishin mjekë specialistë, 386 mjekë stomatologë, 120 farmacistë, 57 fizioterapistë, 8,151 infermierë, 235 bashkëpunëtorë shëndetësorë dhe

2,378 pjesëtarë të stafit jo-mjekësor.

Në bazë të të dhënave të odave të profesionistëve shëndetësorë, në vitin 2025 ishin të licencuar 17,830 punonjës shëndetësorë: 6,491 mjekë,

5,402 infermierë, 2,725 stomatologë, 1,398 fizioterapistë dhe 1,814 farmacistë. Nga numri i përgjithshëm i profesionistëve të licencuar, 10,531 janë meshkuj dhe 7,299 femra.

Mbi 2,300 institucione private të licencuara

ASK-ja ka bërë me dije se gjatë vitit 2025 numri i institucioneve private shëndetësore të licencuara ka arritur në 2,362. Prej tyre, 33 janë spitale, ndërsa 2,329 janë institucione të tjera shëndetësore, përfshirë ambulanca, poliklinika, laboratorë dhe kabinete.

Numrin më të madh të institucioneve private e përbëjnë ambulancat stomatologjike, me 425, pasuar nga ambulancat gjinekologjike me 189 dhe qendrat diagnostike me 167.

PAL LEKAJ DËNOHET ME TRI VJET E TETË MUAJ BURGIM NË RIGJYKIM PËR RASTIN E 53 MILIONËSHIT

PRISHTINË, 9 SHTATOR - Gjykata në Prishtinë e ka dënuar në rigjykim ish-ministrin e Infrastrukturës, Pal Lekaj, me tri vjet e tetë muaj burgim për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe dëmtimit të buxhetit të Kosovës.

Lekaj, së bashku me tre të akuzuarit e tjerë në rastin e 53 milionëshit, Eset Berisha, Nebih Shatri dhe Besim Tahir, u shpallën fajtor të mërkurën për keqpërdorim të detyrës lidhur me autostradën "Arbën Xhaferi".

Tahiri, ish-drejtor i Prokurimit Publik, dhe Shatri, ish-sekretar i Përgjithshëm i kësaj ministrie, u dënuan me nga një vit e tetë muaj burgim, ndërsa Berisha, ish-këshilltar i lartë politik i Lekajt, u dënua me tri vjet e tre muaj burgim.

Gjykata shqiptoi edhe dënim plotësues për ish-deputetin e Kuvendit të Kosovës, Lekaj, duke ia ndaluar për një periudhë prej tri vjet e gjashtë muaj ushtrimin e funksionit në administratën publike.

Rigjykimi ndaj tyre u mbajt pasi në shkurt të vitit 2025 Gjykata e Apelit e kishte kthyer rastin në



pikën zero duke e rrëzuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Edhe në gjykimin e parë, që të katër të akuzuarit kishin marrë dënime sikurse në rigjykim.

Në vitin 2018, Qeveria e Kosovës kishte ndarë 53 milionë euro shtesë për kompaninë në fjalë për punimet e autostradës

Prishtinë - Hani i Elezit, për shkak të, siç kishte thënë Qeveria, dështimit të ekzekutivit të mëhershëm që t'i paguajë me rregull faturat.

Ndërkohë, Prokuroria Speciale e Kosovës tha se e mirëpret aktgjykimin fajësues të Gjykatës Themelore në Prishtinë në rigjykimin ndaj tyre. "Ky

vendim paraqet një hap të rëndësishëm në forcimin e sundimit të ligjit garantimin e ndëshkueshmërisë në rastet e korrupsionit të nivelit të lartë, duke dëshmuar se keqpërdorimi i pozitës zyrtare dhe i parasë publike duhet të ketë përgjegjësi ligjore", tha Prokuroria në një reagim.

Hetimet lidhur me ndarjen e 53 milionë eurove për konsorciumin Bechtel-Enka kishin nisur pas debateve të nxitura dhe dyshimeve të ngritura nga partitë opozitare autoritetet në Kosovë.

Më 2020, Qeveria e udhëhequr nga Albin Kurti, shfuqizoi vendimin e ekzekutivit paraprak për zgjatje të afatit të kontratës për ndërtimin e autostradës "Arbën Xhaferi", që lidh Kosovën me Maqedoninë e Veriut.

Me këtë vendim, Qeveria Kurti ndërpreu negociatat me konsorciumin turko-amerikan, Bechtel-Enka për ndërtimin e lidhjeve të reja dhe të një mbikalimi në autostradë. Ekzekutivi kërkoi po ashtu, që dikasteret përkatëse të bënin vlerësimin e dëmit të shkaktuar në buxhet nga vendimi i shfuqizuar.

Ndryshe, autostrada Prishtinë-Shkup e quajtur "Arbën Xhaferi" ka një gjatësi prej 55 kilometrash dhe ndërtimi i saj i ka kushtuar buxhetit të Kosovës 600 milionë euro.

Kjo autostradë ishte inauguruar më 2019.

Guvernatori i BQK-së takon ambasadorin Malaj, diskutohet bashkëpunimi financiar Kosovë-Shqipëri

PRISHTINË, 9 SHTATOR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, ka pritur në takim ambasadorin e Shqipërisë në Kosovë, Petrit Malaj.

Gjatë takimit u diskutuan zhvillimet në sektorin financiar të Kosovës, reformat e BQK-së, modernizimi i sistemeve të pagesave dhe proceset që lidhen

me integrimin e Kosovës në sistemet evropiane të pagesave, përfshirë SEPA-n dhe projektin TIPS Clone.

Ismaili vlerësoi bashkëpunimin ndërmjet BQK-së dhe Bankës së Shqipërisë, veçanërisht në fushën e mbikëqyrjes financiare, sistemeve të pagesave dhe edukimit financiar.

Ambasadori Malaj përgëzoi

BQK-në për reformat e ndërmarra dhe shprehu mbështetjen për thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve.

Palët rikonfirmuan rëndësinë e bashkëpunimit institucional dhe shkëmbimit të përvojave në funksion të zhvillimit dhe modernizimit të sektorit financiar.



QYMYRI SJELL MILIONA: KU DUHET TË INVESTOHEN?

KEK-u synon të shesë rreth tre milionë tonë qymyr në Maqedoninë e Veriut, përmes një marrëveshjeje me vlerë potenciale prej 73.2 milionë eurosh. Ekspertët thonë se të hyrat duhet të përdoren për modernizimin e minierave dhe termocentraleve të vjetruara dhe rritjen e sigurisë energjetike. Investimet në qymyr vijnë ndërsa Kosova synon të rrisë prodhimin e energjisë së ripërtëritshme dhe të largohet gradualisht nga qymyri deri më 2050

PRISHTINË, 9 SHTATOR - Kosova ka miliarda tonë qymyr nën tokë, por nuk prodhon mjaftueshëm energji elektrike për t'i mbuluar nevojat e veta.

Tani, një pjesë e këtij resursi do të eksportohet.

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) nënshkroi në mes të gushtit një kontratë me kompaninë shtetërore të Maqedonisë së Veriut, ESM, për shitjen e rreth tre milionë tonëve qymyr gjatë tre vjetëve.

Çmimi është fiksuar në 24.40 euro për ton, pa TVSH, duke e çuar vlerën potenciale të kontratës në rreth 73.2 milionë euro.

Megjithatë, kjo nuk do të thotë se KEK-u do t'i arkëtojë domosdoshmërisht të gjitha këto para.

Sipas dokumentit të kontratës, të analizuar nga Energy Monitor, sasia prej rreth tre milionë tonësh mund të devijojë me plus ose minus 30 për qind.

Marrëveshja vjen në një kohë kur sistemi energjetik i Kosovës mbështetet kryesisht në termocentrale të vjetruara, përballet me ndërprerje të paplanifikuara të prodhimit dhe nuk arrin ta mbulojë kërkesën pa importe.

Por, ajo ngre edhe disa pyetje të tjera: a mund ta eksportojë Kosova këtë sasi pa cenuar prodhimin e vet dhe çfarë do të bëjë me milionat që do t'i fitojë nga një resurs prej të cilit, në planin afatgjatë, synon të largohet?

A rrezikohet prodhimi vendor?

Rreth tre milionë tonët e paraparë për eksport përkthehen mesatarisht në rreth një milion ton në vit, nëse dërgesat shpërndahen në mënyrë të barabartë gjatë tre vjetëve. Krahasuar me prodhimin mesatar vjetor prej rreth tetë milionë tonësh të Divizionit të Prodhimit të Qymyrit (DPQ), kjo do të ishte ekuivalente me rreth një të tetën e prodhimit vjetor.

KEK-u nuk u është përgjigjur pyetjeve të Radios Evropa e Lirë lidhur me llogaritjet mbi përfitimin ekonomik të marrëveshjes, por publikisht ka deklaruar se marrëveshja nuk do ta cenojë furnizimin e termocentraleve të Kosovës dhe as prodhimin vendor të energjisë.

Edhe kontrata përmban mekanizma për këtë. Nëse zbatimi i saj rrezikon furnizimin me qymyr të termocentraleve të KEK-ut, Korporata mund ta pezullojë ose ndërpresë furnizimin sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshje.

ESM-ja, në anën tjetër, do t'i bartë kostot e eksploatimit, pajisjeve, ngarkimit dhe transportit të qymyrit.

Kompania maqedonase mund t'i



kryejë këto operacione vetë ose përmes operatorëve ekonomikë që i kontraktin.

Ajo e ka vlerësuar marrëveshjen si të favorshme për sistemin e saj energjetik.

Sipas ESM-së, qymyri i Kosovës ka vlerë mesatare kalorike prej rreth 1.950 kilokalorish për kilogram dhe karakteristika të përshtatshme për termocentralet e saj në Manastir dhe Osllomej.

Ku do të investohen milionat?

KEK-u nuk i është përgjigjur as pyetjes së Radios Evropa e Lirë nëse ka një plan të detajuar për investimin e të hyrave nga kontrata.

Në një deklaratë të 14 gushtit, megjithatë, Korporata tha se ato do të përdoren për mbulimin e kostove operative dhe kapitale, ndërsa një pjesë do të orientohet drejt modernizimit të Divizionit të Prodhimit të Qymyrit. "Të hyrat nga shitja e qymyrit do të kontribuojnë në mbulimin e kostove operative dhe kapitale, ndërsa një pjesë e tyre do të orientohet në modernizimin e infrastrukturës së Divizionit të Prodhimit të Qymyrit, me qëllim të rritjes së kapaciteteve, efikasitetit dhe sigurisë së operacioneve minerare", tha KEK-u.

Muhedin Haxhiu, ish-drejtor i DPQ-së, thotë se investimet në miniera janë të domosdoshme.

Sipas tij, pajisjet janë të vjetruara dhe nevojat shkojnë nga riparimi dhe mirëmbajtja e tyre deri te përmirësimi i kushteve dhe sigurisë së punëtorëve. "Në këtë divizion, pajisjet janë shumë të vjetra, ato kanë nevojë për riparim, mirëmbajtje; punëtorëve t'u krijohen kushtet, siguri, të blihen automjete transportuese... Ka shumë nevoja. Çdo cent që investohet, është i nevojshëm dhe i mirëseardhur", thotë Haxhiu për Radion Evropa e Lirë.

Por, Bukurije Hoxha, profesoreshe në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të

Prishtinës, thotë se investimet nuk duhet të ndalen te minierat.

Sipas saj, modernizimi i kapaciteteve ekzistuese të prodhimit të energjisë duhet të jetë prioritet, ndonëse 73.2 milionë euro janë pak krahasuar me nevojat e sektorit.

Ajo thotë se revitalizimi i minierave dhe modernizimi i termocentraleve duhet të ecin paralelisht. "Qasja duhet të jetë sistimore: nuk mjafton të investohet vetëm në prodhimin e qymyrit nëse kapacitetet e prodhimit të energjisë nuk janë në gjendje ta shfrytëzojnë atë në mënyrë efikase. Po ashtu, nuk ka kuptim të modernizohen termocentralet pa siguruar një furnizim të qëndrueshëm dhe cilësor me qymyr", thotë Hoxha për Radion Evropa e Lirë.

Shumë qymyr, jo mjaftueshëm energji

Kosova ka ndër rezervat më të mëdha të qymyrit në Evropë.

Basenet kryesore të ngjigjllmbajtëse janë ai i Kosovës, Dukagjinit dhe Drenicës, ndërsa resurset e vlerësuara arrijnë në rreth 12.5 miliardë tonë.

Por, pasuria e madhe nëntokësore nuk është përkthyer në siguri të plotë energjetike.

KEK-u është prodhuesi i vetëm në Kosovë i energjisë elektrike nga qymyri, ndërsa termocentralet "Kosova A" dhe "Kosova B" janë të vjetruara.

Sipas Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), gjatë vitit 2025 në Kosovë u prodhuan gjithsej 5.298 GWh energji elektrike.

Prej tyre, 4.687 GWh u prodhuan nga termocentralet, ndërsa 611.5 GWh nga hidrocentralet dhe burimet e tjera të ripërtëritshme. Kërkesa, ndërkaq, arriti në 6.944 GWh dhe diferenca u mbulua përmes importit.

Vjetërsia e termocentraleve ndikon edhe në sigurinë e prodhimit.

Sipas raportit vjetor të ZRRE-së, ndërprerjet e paplanifikuara të njësisë prodhuese gjatë vitit 2025 ishin më të larta se një vit më parë.

"Kjo dëshmon se besueshmëria dhe qëndrueshmëria e termocentraleve po bien nga viti në vit", thuhet në raport.

Të shitet qymyri apo të krijohet më shumë vlerë prej tij?

Përtej të ardhurave nga kontrata me ESM-në, ekspertët ngrënë edhe një pyetje më afatgjatë: sa leverdi ka Kosova nga eksportimi i qymyrit si lëndë e parë?

Hoxha thotë se qymyri nuk duhet të shihet vetëm si mall për eksport apo si lëndë djegëse për prodhimin e energjisë elektrike.

Sipas saj, vlera ekonomike mund të rritet nëse ai përpunohet brenda vendit dhe përdoret për produkte dhe nënprodukte të tjera.

"Një rimodelim i sektorit, duke përfshirë edhe rritjen e kapaciteteve prodhuese, do t'i mundësonte Kosovës stabilitet energjetik, mundësi për eksport dhe, rrjedhimisht, do t'i mundësonte vendit të fitonte një pozitë më të rëndësishme strategjike në sektorin energjetik të rajonit", thotë ajo.

Hoxha përmend mundësinë e përdorimit të qymyrit dhe nënprodukteve të tij në industri, përfshirë hirin termik në prodhimin e çimentos dhe betonit, koxsin në metalurgji, si dhe prodhimin e lëndëve të tjera përmes gazifikimit.

Nëse alternativa të tilla do të ishin ekonomikisht të realizueshme në Kosovë, megjithatë, do të kërkoreshin analiza të veçanta të kostos, tregut dhe ndikimit mjedisor.

Edhe Haxhiu thotë se çështja e eksportit nuk mund të reduktohet në një përgjigje të thjeshtë "po" ose "jo".

Sipas tij, para vendimeve të tilla duhet të analizohen tregu, kërkesa, mundësitë e përpunimit dhe, mbi të gjitha, vlera që Kosova fiton nga shitja e qymyrit si lëndë e parë krahasuar me përpunimin e tij brenda vendit.

"Për këto projekte duhet të ketë institute të

veçanta. Më herët ka qenë INKOS-i në kuadër të KEK-ut. Tashmë një institut i tillë nuk ekziston", thotë ai.

Më 1 shtator, Qeveria në detyrë prezantoi konceptin për themelimin e Institutit Kombëtar Kërkimor për Energinë.

Nuk është bërë e qartë nëse instituti i ri do të marrë funksione të ngjashme me ato që kishte dikur INKOS-i.

Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, tha se ai synohet të shërbejë për zhvillimin e njohurive dhe analizave që lidhen me tranzicionin energjetik.

Investim në qymyr, ndërsa Kosova synon largimin prej tij

Pikërisht tranzicioni energjetik krijon një tjetër dilemë për mënyrën se si do të përdoren të ardhurat nga marrëveshja me ESM-në.

Strategjia e Energjisë e Kosovës 2022-2031 nuk parasheh ndërtimin e termocentraleve të reja me qymyr. Përkundrazi, ajo përcakton që kapacitetet e reja të energjisë së ripërtëritshme ta zëvendësojnë gradualisht përdorimin e qymyrit, me synimin që Kosova të largohet plotësisht prej tij më së largu deri në vitin 2050.

Deri më 2031, strategjia synon që kapacitetet e instaluara të energjisë së ripërtëritshme të arrijnë në 1.600 MW, nga 279 MW që ishin në pikën fillestare të strategjisë.

Por, largimi nga qymyri nuk është i menjëhershëm.

Strategjia parasheh rehabilitimin e "Kosovës B" dhe të së paku një njësie të "Kosovës A", në mënyrë që termocentralet ekzistuese të ruajnë sigurinë e furnizimit gjatë periudhës së tranzicionit.

Kjo do të thotë se Kosova, të paktën për vitet e ardhshme, synon dy gjëra paralelisht: ta mbajë funksional prodhimin nga qymyri dhe, në të njëjtën kohë, të ndërtojë kapacitete që gradualisht do ta zëvendësojnë atë.

Çmimi tjetër i qymyrit

Kjo dilemë nuk është vetëm ekonomike. Prodhimi i energjisë nga qymyri ka edhe kosto mjedisore. Vetë Strategjia e Energjisë evidenton nivele të larta të emetimeve nga njësitë e "Kosovës A" dhe "Kosovës B" dhe parashih investime për uljen e pluhurit, oksideve të azotit dhe dioksidit të squfurit.

Komisioni Evropian, në Raportin për Kosovën të vitit 2025, konstatoi se emetimet e SO₂, NO_x dhe pluhurit në vend u rritën gjatë vitit 2024 krahasuar me një vit më parë dhe tejkaluan kufijtë e përcaktuar.

A DO TË JETË EVROPA PO AQ E PAPËRGATITUR SA ISHTE UKRAINA?



Dymbëdhjetë vjet më parë, Ukraina po ecte në gjumë drejt katastrofës. Tani po e bën Evropa.

Para vitit 2014, ushtria e Ukrainës ishte zbrazur nga dekada neglizhence dhe çarmatimi. Kjo ishte një zgjedhje.

Pse të shpenzosh burime të pakta për mbrojtje kur Memorandumi i Budapestit i vitit 1994 ofronte garanci sigurie në këmbim të dorëzimit të arsenalit bërthamor të Ukrainës? Pse të përgatitesh për një konflikt që konsensusi intelektual mbizotërues thoshte se nuk mund të ndodhte kurrë? Demokracia liberale kishte triumfuar, konflikti mes fuqive të mëdha ishte një relik, dhe harku i përparimit ishte i përkulur drejt paqes, liberalizimit dhe konvergencës ekonomike.

Më keq akoma, Ukraina i lejoi Rusisë të depëronte në hapësirën e saj të informacionit, të promovonte narrativat pro-Kremlinit, të kultivonte aleatë politikë dhe të ndërhynte në zgjedhjet e Ukrainës. Nën presidentin Viktor Janukoviç, një ish-shtetas rus shërbente si ministër i mbrojtjes. Ushtria u sabotua nga brenda.

Ukraina duhej të dinte më mirë. Shenjat paralajmëruese ishin aty. Rusia kishte pushtuar Gjeorgjinë në vitin 2008, duke demonstruar se ishte e gatshme të përdorte forcën ushtarake për të parandaluar që një republikë tjetër ish-sovjetike të largohej nga orbita e saj.

Putini tashmë po vinte në dyshim nëse Ukraina ishte një vend i vërtetë, duke përshkruar pjesë të territorit të saj si një "dhuratë" nga Rusia. Ai publikisht i përshkroi rusët dhe ukrainasit si "një popull," dhe përdori energjia dhe tregtia për të fituar leverdi politike. Megjithatë, besimi se Rusia nuk

do të shkonte më tej pengoi veprime vendimtare.

Pastaj, në shkurt dhe mars 2014, Rusia aneksoi Krimenë pa hapur zjarr sepse pothuajse askush nuk ishte për t'u kundërpërgjigjur (dhe ata që mund të kishin ndihmuar nxitin Ukrainën të tërhiqej). Pak më vonë, Rusia pushtoi pjesë të Donbasit. Këtë herë, Ukraina luftoi për t'u kundërpërgjigjur, por nga një pozicion i thellë dobësie ndaj një armiku më të fortë dhe më të përgatitur.

Ukraina u mundua të arrinte një konsensus mbi atë që kishte ndodhur dhe çfarë duhej bërë. Ndërsa disa kërkonin mobilizim, shumë besonin se lufta ishte lokale dhe e kufizuar në një shirit territori në lindje dhe një gadishull të largët. Më e keqja kishte përfunduar, pohonin ata: Putini kishte marrë atë që donte. Nga kjo rrjedhte se kompromiset, edhe nëse të dhimbshme, mund të sillnin paqen. Sigurisht, lideri i duhur mund të ulej përballë Putinit në tryezë dhe të negociojë një fund të derdhjes së gjakut. Zgjedhja e Volodymyr Zelenskkit në vitin 2019 pasqyroi pjesërisht këtë dëshirë. Zelensky foli për përfundimin e luftës në Donbas, për të folur drejtpërdrejt me Rusinë dhe për të gjetur një gjuhë të përbashkët.

Shumë ukrainas donin të besonin se problemi mund të zgjidhej me bisedë. Përkundrazi, më 24 shkurt 2022, Rusia nisi një pushtim në shkallë të plotë, duke synuar Kievin dhe duke kërkuar të rrëzonte udhëheqjen e shtetit ukrainas. Lufta që duhej të ishte lokale u bë ekzistenciale.

Ngjashmëria e Evropës me trajektoren e Ukrainës është e jashtëzakonshme. Krahassimi nuk është i saktë: Evropa është më e pasur, më e qëndrueshme institucionalisht dhe ende

kryesisht e mbrojtur nga NATO, të paktën në parim.

Por ngjashmëria në zakonet e të menduarit dhe veprimit është mjaft e madhe për të qenë thellësisht shqetësuese, siç dëshmon mjaft mirë reagimi qesharak i Gjermanisë ndaj një sulmi të dështuar rus me dronë në aeroportin e Leipzigut.

Pas dekadash paqeje, Evropa ka çmontuar në mënyrë sistematike kapacitetet e saj mbrojtëse. Udhëzimi i NATO-s për të shpenzuar 2% të PBB-së për mbrojtje, deri kohët e fundit, ishte trajtuar si një tavan e jo si një bazë minimale.

Për dekada, Italia dhe Spanja qëndronte shkopenj fshesash shkopenj fshesash në vend të pushkëve dhe sistemeve kryesore të armëve kishin shkallë gatishmërie nën 50%. Gatishmëria e evropianëve për të forcuar mbrojtjet e tyre përmes reduktimeve të shpenzimeve publike ose dërgesave të forcave paguejtesë në Ukrainë është tronditësisht e ulët.

Mendësia pas këtij neglizhimi është e njohur nga Ukraina para vitit 2014.

Luftërat e mëdha nuk mund të ndodhin: ne kemi Bashkimin Evropian, NATO-n dhe frenimin bërthamor. Shtetet e Bashkuara do të merren me sigurinë. Shpenzimet për mbrojtje janë të kota. Diplomacia dhe ndërvarësia ekonomike do të ruajnë paqen. Rusia kurrë nuk do të sulmonte një partner të madh tregtar.

Këto supozime janë shembur. SHBA-të kanë sinjalizuar me gjithnjë e më shumë hapur se epoka e garancive të sigurisë amerikane pa ndarjen e barrës nga Evropa ka përfunduar. Administrata e presidentit Donald Trump vë në dyshim hapur vlerën e NATO-s. Armët bërthamore nuk pengojnë

agresionin nën prag (si sulmet me dronë dhe kibernetike) ose përdorimin e detyrimit dhe subversione për të minuar sovranitetin. Ajo që bie në sy në pjesën më të madhe të Evropës nuk është vetëm pacifizmi apo gatishmëria e dobët, por edhe ndjenja e vazhdueshme se edhe tani rregullat e vjetra do të rivendosen në njëfarë mënyre.

Evropa tani po përballlet me sinjalet e saj paralajmëruese. Rusia tashmë po zhvillon atë që NATO e quan një fushatë sabotazhi, sulmet kibernetike, ndërhyrja elektronike, dezinformimi dhe ndikimi politik në të gjithë kontinentin. Dronët dhe avionët rusë gjithnjë e më shumë shkelin hapësirën ajrore të NATO-s, ndërsa incidentet të dyshimta rreth kabllave nënujore dhe infrastrukturave të tjera kanë detyruar NATO-n të forcojë mbrojtjen e tyre.

Këto provokime janë qëllimisht nën prapenë dhe luftës. Kjo dykuptimësi i mundëson Rusisë të provojë mbrojtjet evropiane, të testojë vendosmërinë politike dhe të mësojë se sa provokim do të tolerojë Perëndimi para se të reagojë. Dhe, ashtu si Ukraina para vitit 2014, Evropa vazhdon të gjejë arsye për të mos vepruar. Në të gjithë Evropën, mbështetja për riarmatimin dhe për Ukrainën mbetet politikisht e kontestuar.

Në Itali dhe Spanjë, votuesit rezistojnë ndaj rritjes së shpenzimeve për mbrojtje. Në Francë dhe Gjermani, zëra me ndikim e paraqesin urgjencën si një tepëricë reagimi (e djathta ekstreme Alternativa për Gjermaninë, e cila ka të ngjarë të marrë pushtetin në Saksoni-Anhalt, kërkon një marrëveshje me Rusinë).

Në Sllovaki, udhëheqësit kanë mbështetur hap me Rusinë). Në

Sllovaki, udhëheqësit kanë mbështetur hapur përshtatje me Kremlinin.

Rusia financon partitë politike, depërton institucione kulturore, dhe promovon dezinformim në të gjithë Evropën.

Në të gjithë kontinentin, shumë argumentojnë se lufta në Ukrainë mund të përfundojë përmes negociatave, nëse vetëm udhëheqësit e Ukrainës do të ishin më "realistë" për sa i përket koncesioneve territoriale.

Verdikt i Winston Churchill-it për Marrëveshjen katastrofike të Mynihut të vitit 1938 është po aq i vlefshëm si gjithmonë: "Ju u dhatë zgjedhja midis luftës dhe turpin. Ju zgjodhët turpin, dhe do të keni luftë."

Evropa në vitin 2026 mund të investojë seriozisht në mbrojtjen e saj, të pranojë kostot dhe kompromiset e përfshira, dhe të ndërtojë një mospërfillje të besueshme. Ose mund të vazhdojë të shpenzojë pak, të shpresojë se diplomacia e vetme do të mjaftojë, të supozojë se mbrojtja e SHBA-ve do të jetë gjithmonë e disponueshme, dhe t'i thotë vetes se lufta në Ukrainë është një çështje lokale.

Por çmimin e pajtimit nuk e paguajnë kurrë politikanët që zgjedhin lehtësinë mbi vigjilencën. Janë ushtarët dhe civilët që mbajnë pasojat. Evropa ende ka kohë—e cila i është siguruar nga Ukraina, me një kosto të jashtëzakonshme.

Sfida nuk është thjesht të shpenzohet më shumë, por të mendohet ndryshe: të pranohet se mospërshtetësimi nuk është alarmizëm, gatishmëria nuk është provokim, dhe forca shpesh është parakusht për paqe.

| Project Syndicate

A JANË MË TË PASURIT, MË TË PASJELLSHËM? PËRGJIGJJA E PSIKOLOGJISË ËSHTË MË SHQETËSUESE NGA SA DUKET

Kush do të ishte më i gatshëm t'i merrte një karamelë një fëmijë: një njeri me pak para apo dikush që ka shumë dhe hyn tek të pasurit? Pyetja tingëllon si provokim. Por psikologët e kthyen në eksperiment. Dhe përgjigjja hapi një debat shumë më të madh mbi atë që pushteti dhe pasuria mund t'i bëjnë sjelljes njerëzore.

Imagjinoni një eksperiment të çuditshëm. Hyni në një dhomë dhe mbi tavolinë gjeni një kavanoz me karamelë. Studiuesi ju thotë se mund të merrni disa, nëse dëshironi, por ju shpjegon edhe një hollësi: karamelët janë menduar për fëmijët që marrin pjesë në një eksperiment tjetër. Pastaj largohet. Askush nuk po ju sheh. Çfarë bëni?

Kur psikologu social Paul Piff dhe kolegët e tij realizuan një eksperiment të tillë, rezultati ishte befasues: pjesëmarrësit që i përkisnin shtresave më të larta socio-ekonomike morën mesatarisht më shumë karamelë.

Jo pak më shumë. Afërsisht dyfishin e atyre që morën pjesëmarrësit nga shtresat më të ulëta.

Është një nga ato eksperimente që tingëllojnë pothuajse si një shaka për të pasurit. Në fakt, pikërisht për këtë arsye puna e Piff-it dhe kolegëve të tij është rikthyer në vëmendje pasi u vlerësua në edicionin 2026 të Ig Nobel, çmimet që nderojnë kërkimet që fillimisht të bëjnë të qeshsh dhe më pas të mendosh.

Por pas kavanozit me karamelë fshihet një pyetje serioze: A ndryshon sjellja jonë kur kemi më shumë para, status dhe pushtet?

Nuk ishin thjesht karamelët

Eksperimenti me ëmbëlsirat ishte vetëm një pjesë e kërkimit. Në një tjetër studim, studiuesit dolën nga laboratorit dhe vëzhguan drejtuesit e automjeteve në trafik. Rezultati përsëri ishte interesant.

Drejtuesit e makinave që sinjalizonin status më të lartë kishin më shumë gjasa t'u prisnin rrugën automjeteve të tjera në kryqëzime. Në situata të tjera, ishin më pak të prirur t'u jepnin përparësi këmbësorëve.

Në eksperimente të tjera u testua gatishmëria për të mashtruar, për të vepruar në interesin personal apo për të justifikuar sjellje joetike. Dhe vazhdimisht shfaqej një model i ngjashëm. Me rritjen e statusit dhe ndjenjës së fuqisë, në disa rrethana rritej edhe gatishmëria për të vendosur interesin personal përpara nevojave të tjerëve.

Por këtu duhet bërë një dallim i rëndësishëm. Shkenca nuk po thotë se të pasurit janë njerëz të këqij. Po përpiket të kuptojë



diçka shumë më interesante: çfarë i bën pasuria psikologjisë së njeriut?

Kur ke më pak nevojë për të tjerët

Një nga shpjegimet e propozuara nga Piff lidhet me varësinë sociale. Kur ke pak burime, njerëzit rreth teje kanë rëndësi të jashtëzakonshme. Mund të të duhet ndihma e familjes, e fqinjit, e kolegut apo e komunitetit.

Duhet të lexosh më mirë emocionet e njerëzve. Të kuptosh se kush është i gatshëm të të ndihmojë. Të ruash marrëdhëniet. Të bashkëpunosh. Në njëfarë kuptimi, të tjerët janë pjesë e sistemit tënd të mbijetesës.

Të pasurit ndryshojnë një pjesë të këtij ekuacioni

Nëse ke para të mjaftueshme, shumë probleme mund t'i zgjidhësh pa kërkuar ndihmën e askujt. Nuk të duhet një mik për të të çuar diku: paguan transportin. Nuk ke nevojë të kërkosh një nder: paguan një shërbim. Nuk ke nevojë të presësh: paguan për ta shmangur pritjen. Dalëngadalë, autonomia ekonomike mund të shndërrohet edhe në autonomi psikologjike.

Dhe këtu mund të ndodhë diçka e padukshme. Njerëzit e tjerë fillojnë të bëhen pak më pak të domosdoshëm.

Pasuria nuk ndryshon vetëm atë që ke. Ndryshon atë që

mund të bësh

Ka edhe një faktor tjetër: pasojat. Për shumicën e njerëzve, një gabim mund të kushtojë shumë. Humbja e një pune mund të jetë katastrofë. Një gjobë mund të rëndojë buxhetin. Prishja e një marrëdhënieje profesionale mund të mbyllë një derë të rëndësishme. Pasuria krijon një jastëk sigurie. Dhe kur pasojat e një veprimi bëhen më të përballueshme, kufijtë e sjelljes mund të lëvizin. Një gjobë, për shembull, nuk ka të njëjtën fuqi parandaluese për dikë që mezi mbyll muajin dhe për dikë për të cilin ajo përfaqëson një shumë të papërfillshme.

Ligji është i njëjtë. Kostoja psikologjike e shkeljes së tij nuk është. Kjo mund të ushqejë një ndjenjë të fuqishme: rregullat ekzistojnë, por pasojat e tyre nuk më prekin njësoj.

Dhe pastaj vjen meritokracia

Ndoshta mekanizmi më interesant është mënyra se si njerëzit shpjegojnë suksesin e tyre. Kur dikush ngjitet në hierarkinë ekonomike apo sociale, është shumë njerëzore t'ia atribuojë suksesin inteligjencës, punës, talentit dhe vendimeve të veta.

Dhe shpesh këto kanë vërtet rëndësi.

Por në histori personale harrohen më lehtë elementet që nuk varen plotësisht prej nesh: familja ku lindëm, arsimi që morëm, njerëzit që takuam, momenti i duhur, vendi i

duhur, mundësitë që na u hapën dhe, po, edhe fati.

Sa më shumë ta shohësh suksesin si produkt ekskluziv të meritës tënde, aq më e lehtë bëhet të arrish në përfundimin tjetër: Nëse unë e arrita vetë, përse nuk e arrijnë edhe të tjerët? Dhe prej këtu distanca mes suksesit ekonomik dhe gjykitimit moral mund të bëhet shumë e vogël. Unë kam shumë sepse e meritoj. Ata kanë pak sepse nuk janë përpjekur sa duhet. Pabarazia, kështu, nuk duket më si rezultat i një sistemi kompleks mundësisht, avantazhesh dhe zgjedhjesh. Fillon të duket e drejtë.

Shkaku mund të jetë edhe i kundërt

Këtu historia bëhet shkencërisht më interesante. Edhe nëse njerëzit më të pasur shfaqin mesatarisht disa sjellje më egoiste në eksperimente të caktuara, kjo nuk provon automatikisht se paraja i ka bërë të tillë. Mund të funksionojë edhe e kundërta. Ndoshta disa tipare – konkurrueshmëria ekstreme, marrja e rrezikut, orientimi i fortë drejt interesit personal – e bëjnë një person më të aftë për të grumbulluar pasuri në disa mjedise.

Pra, a i bën pasuria njerëzit më egoistë? Apo kanë disa njerëz më egoistë më shumë gjasa të bëhen të pasur?

Dhe sigurisht ekziston një mundësi e tretë: të dy mekanizmat mund të veprojnë njëkohësisht. Personaliteti ndikon te sukcesi, pastaj

suksesi ndryshon mjedisin, dhe mjedisi përforcon disa tipare të personalitetit.

Pushteti mund të jetë më i rëndësishëm se vetë paratë

Në fakt, ndoshta fjala kyçe nuk është “pasuri”. Është pushtet. Paraja është vetëm një nga format e tij. Statusi, fama, autoriteti profesional apo politik mund të krijojnë të njëjtën distancë nga njerëzit e tjerë. Sa më lart ngjitesh në një hierarki, aq më pak njerëz të thonë “jo”. Shakatë e tua bëjnë më për të qeshur. Idetë e tua duken më interesante. Gabimet e tua korrigohen më rrallë. Njerëzit të ndërpresin më pak. Dhe më e rëndësishmja: gjithnjë e më shumë njerëz kanë interes të të pëlqejnë.

Ky është një mjedis psikologjik i rrezikshëm për këdo. Sepse njeriu fillon të humbasë një prej mekanizmave më të rëndësishëm të vetëkorrigimit: rezistencën e njerëzve të tjerë.

Paradoksi i pasurisë


Kjo e bën gjithë këtë temë kaq interesante. Ne e kërkojmë pasurinë sepse ajo na jep liri. Paraja mund të na çlirojë nga ankthi, pasiguria dhe varësia. Mund të na japë arsim më të mirë, shëndet, kohë, përvoja dhe mundësi. Por pikërisht ajo që na çliron nga varësia ndaj të tjerëve mund të na largojë pak nga ata.

Megjithatë, nuk është e pashmangshme. Ka njerëz jashtëzakonisht të pasur që janë bujarë, empatikë dhe të ndërgjegjshëm. Ashtu siç ka njerëz pa pasuri që mund të jenë egoistë dhe të pamëshirshëm.

Psikologjia nuk funksionon me kategori morale kaq të thjeshta. Ajo që sugjerojnë këto studime është më delikate: mjedisi ku jetojmë ndryshon sjelljen tonë më shumë nga sa duam ta pranojmë. Dhe pasuria krijon një mjedis shumë të veçantë. Më shumë kontroll. Më shumë autonomi. Më pak varësi. Më pak pasoja. Më shumë njerëz që të thonë “po”.

Eksperimenti me karamelët, në fund të fundit, nuk është interesant sepse disa njerëz të pasur morën ëmbëlsira që ishin destinuar për fëmijët.

Është interesant sepse na kujton diçka shumë më universale. Karakterin e vërtetë të njeriut e ndryshon dalëngadalë pushteti për të mos pasur nevojë nga askush. / bota.al



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

625 mijë euro për sportistët dhe trajnerët e Kosovës

PRISHTINË, 9 SHTATOR - Ministria e Sportit dhe Rinisë ka vazhduar mbështetjen financiare për sportistët dhe trajnerët e kategorizuar, duke ndarë gjithsej 625 325 euro për 150 përfitues. Sipas njoftimit të kësaj ministrie, nga kjo shumë, 96 sportistë do të përfitojnë gjithsej 448 150 euro, ndërsa 54 trajnerë do të

mbështeten me 177 175 euro. Ministria e Sportit dhe Rinisë ka bërë me dije se kjo mbështetje është shprehje e vlerësimit për punën, disiplinën dhe rezultatet e sportistëve dhe trajnerëve, të cilët përfaqësojnë Kosovën në gara vendore dhe ndërkombëtare. "Kjo mbështetje është shprehje e vlerësimit për

punën, disiplinën dhe rezultatet e sportistëve dhe trajnerëve tanë, të cilët me përkushtimin e tyre përfaqësojnë Kosovën në arenën vendore dhe ndërkombëtare. Çdo rezultat nis me përkushtim, ndërsa çdo sukses ndërtohet me punë të palodhshme. Urojmë që kjo mbështetje t'ju japë edhe më shumë motivim

e kurajë për të vazhduar të punoni, të tejkaloni kufijtë tuaj dhe të synoni rezultate edhe më të mëdha në garat që ju presin. Sukseset e sportistëve tanë janë krenari për Kosovën. Ne do të vazhdojmë të jemi pranë tyre në çdo hap të këtij rrugëtimi", ka njoftuar Ministria e Sportit dhe Rinisë.



PRISHTINA VAZHDON SERINË POZITIVE, LLAPI REALIZON FITOREN E PARË



PRISHTINË, 9 SHTATOR - Prishtina ka vazhduar formën e shkëlqyer në Albi Mall Superligën e Kosovës, duke regjistruar fitoren e katërt radhazi. Në stadiumin "Bajram Aliu", në kuadër të xhiros së pestë, Prishtina ka triumfuar bindshëm ndaj Drenicës me rezultat 4:1. Bardhekaltrit e kryeqytetit e kanë nisur ndeshjen në mënyrën më të mirë të mundshme, duke kaluar në epërsi që në minutën e pestë. Kastriot Selmani ishte ai që ka zhblokuar takimin. Drenica ka reaguar para përfundimit të pjesës së parë dhe në minutën e 40-të ka arritur ta barazojë rezultatit përmes Shkëlzen

Lushtakut. Megjithatë, Prishtina e ka nisur pjesën e dytë furishëm. Në minutën e 51-të, Diar Halili ka shënuar për 2:1, ndërsa vetëm gjashtë minuta më vonë Assane Diatta ka realizuar nga penalltia për 3:1. Fitoren e Prishtinës e ka vulosur Ardian Hasani, i cili ka shënuar golin e katërt në minutën e 86-të. Me këtë fitore, Prishtina shkon në kuotën e 12 pikëve, duke pasur edhe një ndeshje më pak të zhvilluar, atë me Dritën. Për Drenicën kjo ishte humbja e dytë e sezonit, ndërsa skuadra kuqezi ka regjistruar edhe tri barazime dhe aktualisht numëron tri pikë. Ndërkohë, Llapi ka marrë tri

pikët e para në këtë edicion, pasi në stadiumin "Liman Gegaj" në Malishevë ka triumfuar bindshëm ndaj Vushtrrisë, me rezultat 4:0. Skuadra llapjane e ka kontrolluar ndeshjen, duke krijuar epërsi të dyfishtë që në pjesën e parë. Arbnor Ramadani e ka zhblokuar takimin në minutën e 17-të, ndërsa Fiton Ademi ka shënuar për 2:0 në minutën e 36-të. Llapi ka vazhduar me ritëm të njëjtë edhe pas pushimit. Pas një ore lojë, Arianit Hasani ka realizuar për 3:0, ndërsa rezultatit përfundimtar e ka vendosur Mërgim Cërnavëri, i cili ka shënuar në minutën e 90-të.

KRESHNIK UKA, YLLI QË PO BËN DALLIMIN TE MALISHEVA: MUND TË SHPALLEMI KAMPIONË TË KOSOVËS

MALISHEVË, 9 SHTATOR - Nëse Malisheva e ngre nivelin dhe tregon konsistencë nga ndeshja në ndeshje, atëherë mund ta fitojë edhe titullin e kampionit të Kosovës. Kështu ka deklaruar ylli më në formë i skuadrës, Kreshnik Uka.

31-vjeçari është ambientuar shpejt te skuadra e Thomas Brdariq, pasi iu bashkua nga Prishtina, ku menjëherë ka nisur të bëjë dallimin me gola. Në vetëm tetë paraqitje, ai tashmë e ka tundur rrjetën plot shtatë herë, duke përfshirë ndeshjet në elitën e futbollit kosovar dhe kualifikueset për garat evropiane.

Malisheva ishte e pafat në Evropë, pasi eliminoi Vllazninë e Shkodrës, ndërsa në raundin pasues shorti e përballi me Hibernianin. Malisheva është eliminuar pas dy ndeshjeve, me rezultat të përgjithshëm 4-3. Sidoqoftë, Malisheva ka treguar një nivel krejt tjetër në Superligën e Kosovës. Brenda katër xhirore të para, Malisheva është lidere me 10 pikë, ndërsa ende nuk e ka provuar "shijen" e humbjes.

Uka u ka dhënë lëvdata lojtarëve dhe stafit të trajnerëve për formën që po kalojnë, derisa ka theksuar se duhet ta ruajnë këtë ritëm.



"Kam filluar mjaft mirë sezonin me gola, duke i ndihmuar

skuadrës. Mementalisht është një edicion interesant, edhe pse

është herët të vlerësohet. Padyshim që merita është e lojtarëve dhe e gjithë stafit të trajnerëve. Besoj që duhet ta mbajmë këtë ritëm edhe më tutje", ka thënë Uka për "Telegrafin".

Përkundër formës fantastike, objektivi kryesor i Malishevës mbetet kualifikimi në garat evropiane, ndonëse Uka shpreson për diçka më shumë. "Normal, objektivi kryesor është dalja në Evropë, por pse jo edhe titulli kampion. Nëse e rrisim nivelin e paraqitjeve nga loja në lojë, me ndihmën e Zotit mund të shpallemi edhe kampion", ka thënë ai.

Shqipëria pa Strakoshën në Ligën e Kombeve

TIRANË, 9 SHTATOR - Kombëtarja e Shqipërisë mund ta ketë një mungesë të madhe në ndeshjet e Ligës së Kombeve që do t'i luajë këtë muaj. Portieri Thomas Strakosha nuk pritet të jetë në dispozicion të selektorit Rolando Maran për duelet me Bjellorusinë dhe

San Marinon.

Strakosha i ka munguar AEK-ut të Athinës në fitoren 1:0 ndaj LASK-ut në kuadër të Ligës së Kampionëve, ndërsa klubi grek ka bërë me dije se ai pritet të rikthehet në fushë muajin e ardhshëm.

Portieri 31-vjeçar është

lënduar në duelin e fundit në kampionat ndaj Arisit dhe do t'i mungojë ekipit të tij edhe në tri përballjet e ardhshme. Bazuar në këtë, Strakosha nuk do të jetë në gjendje të jetë gati për lojë deri pas përfundimit të pushimit për ndeshjet e kombëtareve. Shqipëria më 26

shtator luan në shtëpi kundër Bjellorusisë, ndërsa tri ditë më vonë përballjet me San Marinon në Ligën e Kombeve. "Kuqezinjtë" në sezonin e ri të kësaj gare do të jenë pjesë e Ligës C dhe janë në Grupin I, të cilin e përbën edhe Finlanda.





Bazuar në Ligjin e Punes Nr. 03/L-212, konkretisht Neni 8, bazuar në Rreguloren nr. 07/2024 për Marrëdhënien e Punës në KRM “Pastrimi” Sh. A. konkretisht nenin 11, paragrafi 1.2 dhe 12, bazuar në Rreguloren Nr. 01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRM “Pastrimi” SH.A, bazuar në Vendimin e datës 07.09.2026 me numër të protokollit 02/01/537 të Kryeshefit Ekzekutiv të KRM “Pastrimi” SH.A. shpallë këtë:

Për plotësimin e vendit të punës

Titulli i Vendit të punës:	Kontrollor Intern Operativ
Nr. i kërkuar:	Një (1) pozitë, KRM "Pastrimi" SH.A.,-Prishtinë
Numri i Referencës:	KP/RR/NJOP/25-2026
Koeficienti/Paga mujore:	Niveli X
Kohëzgjatja e Kontratës së Punës:	Me kohë të pa caktuar
Perjudha Provuese:	3 muaj

- 1.1 Inspekton dhe kontrollon shërbimin e amvisërisë, bizneseve dhe kontratave të veçanta, duke evidencuar dhe raportuar çdo keqpërdorim apo parregullsi eventuale që dëmton interesin dhe imazhin e kompanisë;
- 1.2 Bashkëpunon me Udhëheqësin e njësisë rreth kontrollës interne dhe me stafin e kompanisë lidhur me planet konkrete të veprimit dhe punës,
- 1.3 Mban ditarin personal të punës së inspektimeve në të cilin evidencën, inspektimet, vërejtjet dhe veprimet e ndërmarra dhe të bëna përpunimin analitik të të dhënave, për të cilat raporton tek Udhëheqësi në baza javore-
- 1.4 Siguron se të gjitha raportet dhe të dhënat e paraqitura nga fushëveprimi i inspektimit të tij, janë të sakta dhe në përputhje me gjendjen reale, të cilat në rast kontesti do t'i argumentoj;
- 1.5 Nën instruksionet e udhëheqësit të kontrollës interne, kryen punët dhe detyrat operative të kontrollës në teren, lidhur me kryerjen e shërbimeve ndaj konsumatorëve, kualitetin dhe rrjedhjen e tyre
- 1.6 Inspekton terrenin e kamionëve gjatë transportit në linja grumbulluese;
- 1.7 Në bashkëpunim me udhëheqësin e drejtpërdrejtë, inspekton dhe raporton keqpërdorimet eventuale të së drejtës në pushim mjekësor dhe çfarëdo keqpërdorimi tjetër;
- 1.8 Inspekton respektimin e orarit të punës nga të punësuarit në teren dhe në raste të kërkesës edhe në administratë;
- 1.9 Të inspektoj dhe verifikoj numrin e zbrazjeve dhe saktësinë e tyre;
- 1.10 Të intervetoj menjëherë në rastet kur t'i jepet urdhi konkret për veprim;
- 1.11 Kryen punë tjera sipas urdhërësës së udhëheqësit drejtpërdrejtë;
- 1.12 Për punën e tij i përgjigjet Udhëheqësit të Njesisë së Kontrollës Interne Operative

- ✓ Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- ✓ Të zotërojë të paktën njërin nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- ✓ Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- ✓ Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale;
- ✓ Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- ✓ Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën
- ✓ Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në ligj.

✓ Arsimimi i kërkuar: Diplomë universitare apo shkollim i mesëm

✓ Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 1 vit përvojë pune

- ✓ Afësi të arsyetimit logjik dhe analizës;
- ✓ Afësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë afësi për të përfaqësuar.
- ✓ Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- ✓ Afësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- ✓ Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;

Kërkesa për punësim dhe CV-ja, e plotësuar dhe nënshkruar nga kandidati	✓
Dëshmi të kualifikimeve shkollore nga Institucionet Arsimore	✓
Kopje të dëshmisë së punësimit (Trusti Pensional, Vërtetimi, apo Kontratë të Punës)	✓
Kopje të dëshmisë së trajnimeve dhe kurseve (e dëshirueshme)	✓
Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit (e dëshirueshme)	✓
Dokument identifikimi e Republikës së Kosovës	✓
Vërtetim nga Gjykata që personi nuk është nën hetime, JO më të vjetër se 6 muaj	✓

- Patentë shoferi obligator për shoferët e kategorisë: B, C dhe C1

* duke e shkarkuar nga faqja zyrtare në rrjetin social Facebook: Kompania Rajonale e Mbeturinave "Pastrimi" Sh. A.

* Kërkesa për punësim, me dokumentacionin e kompletuar bëhet vetëm në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës: punesimi.krmpastrimi@gmail.com në formatin PDF dhe

* Në rastet e konkurseve të brendshme dhe jashtme për pozitat teknike mund të bëhet edhe në formë fizike nëpërmjet Arkivës së kompanisë.

Koha e fundit e pranimit të aplikimeve është ora 16:00.
Të gjitha aplikimet që arrijnë pas afatit të fundit nuk do të merren parasysh.

Procedura e vlerësimit përmban gjithsejtë njëqind (100) pikë, ku kalueshmëria është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e Konkursit Publik.

- ✓ Testit me shkrim: deri në 60 pikë
- ✓ CV-ja e kandidatit: deri në 10 pikë
- ✓ Intervistimi: deri në 30 pikë.

Të gjithë kandidatët do të njoftohen nëpërmjet komunikimit elektronik dhe individualisht.

Faza e verifikimit paraprak të aplikacioneve deri në 7 ditë;
Faza e testit me shkrim deri 10 ditë pas fazës së verifikimit,
Faza e Intervistës deri 7 ditë pas shpalljes së rezultateve të testit me shkrim.
Publikimi i rezultateve bëhet deri në 3 ditë pas vlerësimit të intervistës.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpeite

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553



F2.2 / BNJ-KP /



REGIONALNO PREDUZEĆE ZA OTPAD "PASTRIMI" AD

Na osnovu Zakona o radu br. 03/L-212, posebno člana 8, na osnovu Uredbe br. 07/2024 o radnim odnosima u RPO "Pastrimi" AD, posebno član 11, stavovi 1.2 i 12, na osnovu Uredbe br. 01/2024 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta u KRM "Pastrimi" AD, na osnovu Odluke od 07.09.2026. godine sa brojem protokola 02/01/537 Generalnog direktora RPO "Pastrimi" SH. A, izjavljuje ovo:

JAVNI KONKURS

Za popunjavanje radnog mesta

Naziv posla:	Interni operativni kontrolor
Potreban broj:	Jedna (1) pozicija, RPO "Pastrimi" AD, Priština
Referentni broj:	KP / RR / NJOP / 25-2026
Koeficijent / Mesečna plata:	Nivo X
Trajanje ugovora o radu:	Stalno
Probni period:	3 meseca

1. Dužnosti i odgovornosti:

- 1.1. Proverava i kontroliše usluge domaćinstva, preduzeća i posebne ugovore, snimanje i prijavljivanje bilo kakve zloupotrebe ili potencijalnih nepravilnosti koje štete interesima i imidžu kompanije;
- 1.2. sarađuje sa šefom Jedinice u oblasti unutrašnje kontrole i sa osobljem kompanije u vezi sa konkretnim akcionim i radnim planovima;
- 1.3. Vodi lični radni dnevnik inspekcija u kojem beleži inspekcije, primedbe i preduzete radnje, i vrši analitičku obradu podataka, izveštavajući lidera na nedeljnom nivou.
- 1.4. Obezbeđuje da su svi izveštaji i podaci dostavljeni u okviru njegove inspekcije tačni i u skladu sa stvarnom situacijom, koju će potkrijepiti u slučaju spora;
- 1.5. Po uputstvima šefa interne kontrole, obavlja operativne poslove i zadatke terenskih inspekcija u vezi sa pružanjem usluga korisnicima, kvalitetom i njihovim tokom
- 1.6. Pregledava teren kamiona tokom transporta na sabirnim linijama;
- 1.7. U saradnji sa direktnim supervizorom, vrši inspekciju i prijavljuje eventualne zloupotrebe prava na medicinsko odsustvo i svaku drugu zloupotrebu;
- 1.8. vrši inspekciju poštovanja radnog vremena zaposlenih na terenu i, na zahtev, i u administraciji;
- 1.9. Pregledati i proveriti broj praznina i njihovu tačnost;
- 1.10. Da odmah interveniše u slučajevima kada je dat poseban nalog za postupanje;
- 1.11. obavlja i druge poslove po nalogu direktnog supervizora;
- 1.12. Za svoj rad odgovara šefu Jedinice za unutrašnju operativnu kontrolu

2. Opšti kriterijumi za zapošljavanje:

- ✓ Mora biti državljanin Republike Kosovo,
- ✓ mora vladati najmanje jednim od službenih jezika, u skladu sa Zakonom o jezicima;
- ✓ Mora biti sposoban za obavljanje odgovarajuće dužnosti;
- ✓ Da nije osuđen za počinjenje krivičnog dela;
- ✓ Ne smije postojati disciplinska mjera na snazi za ozbiljan prekršaj u javnoj ustanovi;
- ✓ Da imaju obrazovanje, profesionalno radno iskustvo, i / ili vještine potrebne za poziciju
- ✓ Da uspešno prode procedure prijema definisane zakonom.

3. Opšti formalni zahtevi

- ✓ Potrebno obrazovanje: Visoka stručna sprema ili srednje obrazovanje
- ✓ Potrebno radno iskustvo: Najmanje 1 godina radnog iskustva

4. Znanja, veštine i kvalitete potrebne u postupku zapošljavanja

- ✓ Logičko zaključivanje i analitičke veštine;
- ✓ Komunikacijske vještine i lični uticaj, uključujući sposobnost predstavljanja.
- ✓ istraživačke, analitičke, evaluativne veštine i formulisanje stručnih preporuka i saveta;
- ✓ Sposobnost donošenja nezavisnih profesionalnih prosudbi, vršenja diskrecije o pitanjima i značajnog doprinosa razvoju i sprovođenju politika;
- ✓ Veliko znanje o terenu i istraživačkih metoda koje pomažu u pripremi osnovnih ili analitičkih izveštaja;

5. Dokumenti koji se podnose u okviru prijave i način njihovog podnošenja

Prijava za zapošljavanje i biografija, popunjen i potpisan od strane kandidata	✓
Dokaz o školskoj spremi iz obrazovnih ustanova	✓
Kopija dokaza o zapošljavanju (penzijski fond, sertifikat ili ugovor o radu)	✓
Kopija sertifikata o obuci i kursu (opcionarno)	✓
Kopije ocena rada za poslednje dve godine (poželjno)	✓
Identifikacioni dokument Republike Kosovo	✓
Potvrda Suda da osoba nije pod istragom, NE starija od 6 meseci	✓

5.1 Posebni dokumenti

- Obavezna vozačka dozvola za vozače kategorija B, C i C1

6. Postupak prijave na konkurs i podnošenje prijave:

6.1 Povlačenje zvaničnih obrazaca se vrši:

- * na recepciji kompanije.

6.2 Podnošenje prijave:

- * Zahtjevi za zapošljavanje, sa kompletnom dokumentacijom, podnose se isključivo elektronskim putem na adresu: punesimi.krmpastrimi@gmail.com u PDF formatu i

7. tačan datum i vreme zatvaranja javnog konkursa:

Javni konkurs traje 15 dana od 09.10.2026. do 24.09.2026. godine.

Rok za podnošenje prijave je 16:00 časova.

Sve prijave podnesene nakon isteka roka neće se razmatrati.

8. Metod ocenjivanja i kriterijumi bodovanja.

Postupak vrednovanja sadrži ukupno stotinu (100) bodova, pri čemu je prolaz ostvarivanje najmanje pedeset pet (55) bodova iz svih faza javnog konkursa.

Ocenjivanje kandidata se zasniva na:

- ✓ Pismeni test: do 60 bodova
- ✓ CV kandidata: do 10 bodova
- ✓ Intervju: do 30 bodova.

9. Način obaveštavanja i komunikacije sa kandidatima.

Svi kandidati će biti obavješteni putem elektronske komunikacije i pojedinačno.

10. Približan raspored postupka zapošljavanja:

Preliminarna verifikacijska faza prijava do 7 dana:

Faza pismenog testiranja traje do 10 dana nakon faze verifikacije.

Faza interviua traje do 7 dana nakon objavljivanja rezultata pismenog testa.

Rezultati se objavljuju do 3 dana nakon evaluacije intervjua.

Napomena: Nepotpuna ili neskenirana dokumenta, kao i ona koja stignu nakon isteka roka za takmičenje, neće se razmatrati.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Milazim Dana shpall të pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën QK “11 Marsi” Prizren.
- Shaban Kryeziu shpall të pavlefshme diplomën QK “11 Marsi” Prizren.
- Driton Bucaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “ Abdyl Frasheri “ Prizren.
- Armend Hoxhaj shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q K “11 Marsi” Prizren.
- Trim Rezniciq shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p “Gjon N. Kazazi” Gjakovë.
- Sokol Haxhikadrija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33049408.
- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811149542 të lëshuar nga ARBK.
- Genti Kurhasku shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të sh.m. mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Sebastjan Prenka shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shf.f.m.u “Ahmet Rustemi” Bec Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.
- Xhelal Halilosmani shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e sh.m. Ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.
- Diana Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Albana Gjocaj nga Juniku shpall të pavlefshme diplomën e universiteti Publik “Fehmi Agani” Gjakovë, drejtimi Infermieri, Bachelor me nr. 104.
- At dhe Gashi shpall të pavlefshme dëftesat diplomën si dhe certifikatën e diplomës të shkollës së mesme Teknike “28 Nëntori” Prishtinë.
- Valmir Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti” në Mazdrek.
- Elton Halili shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 11 të shkollës së mesme të lartë të mjekësisë “Dr. Xheladin Deda”.
- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.
- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m.”Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

